



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 29 DHE 30 DHJETOR 2016**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 29. I 30. DECEMBRA 2016. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-261 o ratnim veteranima Oslobodilačke vojske Kosova

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Në qoftë se brenda 10 minutave nuk arrijmë t'i kemi 61 veta, seancën do ta shtyjmë për ditën e nesërme.

Ka propozim konkret nga kolegët deputetë, mëditjet e ditës së sotme nuk jepen në qoftë se s'arrihet të jenë 61 deputetë. Është penaltia e dytë në këtë muaj për t'i hequr mëditjet.

Të nderuar kryetarë të grupeve parlamentare të pozitës, po shihet se kolegët e opozitës s'duan të vijnë. I kemi edhe për 5 minuta për të pasur kuorum, seanca shtyhet për t'u mbajtur nesër.

I përshëndes përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta, të cilët janë duke e përcjellë këtë seancë dhe po e shohin edhe vetë që s'ka gatishmëri nga kolegët e opozitës të kthehen në sallë.

Ne s'po mund të arrijmë të kemi kuorum. Prandaj, pasi s'po mund t'i bëjmë sonte 86 vota, këtë do ta bëjmë nesër.

Pra, seanca shtyhet për nesër dhe mbahet në orën 10:00. Faleminderit! Mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 29 dhjetor
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar kryeministër,
Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale,
I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendi të Republikës së Kosovës.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, ka kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme më 29 dhjetor 2016 për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Seanca e thirrur më 29 dhjetor 2016 në mungesë të kuoromit është shtyrë për sot.

Deputetë të nderuar,
Para se të fillojmë me shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kuvendi duhet të vendosë për shmangie nga afatet procedurale të parapara me dispozitat e Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e projektligjeve.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar, deputetin Zenun Pajaziti, që ta paraqesë propozimin.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!
Zoti kryeministër,
Kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i propozon Kuvendit për miratim këtë:

Propozim-vendim

Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1, nenin 57, paragrafët 3, 5, 8 dhe 9, dhe nenin 64 të Rregullores së Kuvendit dhe atë, si në vijim.

1. Shqyrtimi i parë të bëhet në seancën plenare më 30 dhjetor 2016, pra sot, dhe

2. Pas miratimit të shqyrtimit të parë, komisionet funksionale dhe ato të përhershme t'i trajtojnë këto amendamente dhe t'i prezantojnë raportet e tyre në një seancë të re, e cila të mbahet po ashtu sot.

Shqyrtimi i dytë i projektligjit të bëhet në seancën plenare, pra sot, pas përfundimit të punës së komisioneve përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë zonja Xhevahire Izmaqu e ka kërkuar fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju qytetarë të vendit,

Dje e keni parë që ne deputetet e Kuvendit të Kosovës, kryesisht të Partisë Demokratike e lëshuam për disa momente seancën, ndërsa sot më lejoni që të flas në emër të dy grupeve parlamentare, PDK dhe LDK, lidhur me një protestë të cilën dëshirojmë ta realizojmë sot në shenjë reagimi ndaj fyerjeve të vazhdueshme që ditëve të fundit janë duke ardhur nga ish-Avokati i Popullit në raport me ministren e Drejtësisë, zonjën Dhurata Hoxha, por në raport edhe me të gjitha gratë në politikë.

Më lejoni, pasi dje ne pritëm që të kemi një reagim edhe një kërkim-falje nga ky zotëri, ne sot vazhdojmë me një protestë 5-minutëshe këtu në Kuvend. I nderuar kryetar, të ndërpritni seancën dhe në shenjë përkrahjeje dhe solidariteti, por edhe në shenjë të distancimit nga ato fyerje të cilat janë të papranueshme, posaçërisht kur vijnë nga një njeri i cili vjen nga një familje e kulturuar intelektuale dhe atdhetare, që ne sot ta ndërpresim seancën për disa minuta, e që me këtë rast ta tregojmë reagimin tonë të ashpër, por gjithashtu edhe indinjatën tonë me këto fyerje të vazhdueshme që vijnë po ashtu një javë rresht nga ky njeri.

Pra, kërkoj që të ngriheni në këmbë në shenjë të solidariteti dhe distancimi nga këto fyerje dhe gjithashtu kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare që në fillim të vitit ta mbajmë një seancë, e cila do ta kundërshtojë ashpër dhe t'i ndalë njëherë e përgjithmonë nga çfarëdo grupi, nga çfarëdo qytetari, apo personi, fyerjet që vijnë në drejtim të krerëve të institucioneve, por edhe të grave.

Pastaj, ne të gjithë së bashku do të vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së rëndësishme që është sot Ligji për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

(Ndërhyrje, reagime nga salla)

KRYETARI: Regjia! Ju kisha lutur, qetë! Urdhëro Daut, a do të flasësh. Dil fol prej vendit, pasi e ka foltoren deputetja. Të gjithë keni për të folur.

DAUT HARADINAJ: Asnjë njeri nuk është normal nëse pajtohet me gjuhën fyese kundër një personi, kushdo qoftë ai, qoftë gjini femërore apo mashkullore.

Nëse duhet distancuar prej fjalorit fyes, duhet kryeministri i pari të çohet e të dalë në foltore këtu, kujt i ka thënë gomar, kujt i ka thënë pulë, kujt këndues, kujt qurë... Krejt duhet të jenë të barabartë, nuk ka këtu një femër e një mashkull. Nëse kemi gjuhë fyese ndaj dikujt, kushto qoftë ai person, ne jemi dakord të distancohemi, por jo tash të keqpërdoret foltorja këtu - 'hajde çohemi në këmbë'. Dje e lëshuan sallën. Vetë e thirrën seancën, vetë e bojkotuan në sallë pikërisht kur ishte momenti të votohej për urën dhe murin në Mitrovicë.

Unë mendoj që është shumë më i rëndësishëm muri në Mitrovicë se sa një gjuhë fyese.

Në fund të fundit, është një person i cili e ka fyer një zyrtar të shtetit dhe që jemi dakord që është gjuhë e papranueshme për të gjithë. Por, në rast se shefi i asaj zyrtareje e ka quajtur një qytetar të Kosovës, kushdo qoftë ai, a është deputet, a zyrtar, a ministër, i ka thënë: "I kërkoj falje gomarit që e kam krahasuar me filan fistekun, me Albin Kurtin", atëherë a nuk është gjuhë fyese kjo, a?!

Në fund të fundit, ku është dallimi ndërmjet lopës e gomarit? Arben? Duhet të jemi tash ne të qartë.

Përfundimisht, kur të thirrni seancë për veteranët, për urën e Ibrit, është mirë të kyçeni aty.

Ministrja e ka gojën e vet, di të flasë. Ajo çikë e zonja, është çikë e mirë dhe ne përgëzojmë për punën që e bën. Ajo mund të flasë vetë për këtë temë.

KRYETARI: Shqipe Pantina e ka kërkuar fjalën. Ngriheni dorën kush do të flasë për këtë çështje, pastaj Arbeni...

SHQIPE PANTINA: Në fakt, çdo gjuhë fyese, pa marrë parasysh kush e thotë atë dhe ndaj kujt është e drejtuar është e papranueshme. Kushdo që e ka thënë ndaj kujt. Megjithatë, ka një dallim kur diçka të tillë e thotë një person që nuk ka asnjë post publik tashmë, është person fizik dhe është krejt ndryshe kur shprehjet e tilla përdoren nga krerët e shtetit, nga kryeministri dhe nga kryetari i Kuvendit, sepse kryetar as ju nuk mund të përjashtoheni nga kjo, sepse ishin edhe ju që përdorët gjuhë të ngjashme fyese ndaj kolegeve tua këtu në Kuvend.

Dhe, për koleget nga PDK-ja, nëse jeni parimore dhe vërtet doni ta dënoni, unë mendoj se duhet të filloni nga oborri juaj, filloni duke e dënuar së pari gjuhën e Adem Grabovcit ndaj Flora

Brovinës. Nuk ka pas asgjë më fyese se sa ajo. Është fyer personalisht dinjiteti i saj dhe askush, as koleget e saj nuk kanë reaguar dhe askush nuk ka kërkuar falje. Kështu që nëse po vendosim prej sot e tutje, po vendosni ju ta pastroni fjalorin tuaj, hajde të fillojmë prej kryeministrit dhe prej kryetarit të Kuvendit dhe po, pastaj ne jemi dakord dhe solidarizohemi me këto kërkesa, por të fillojmë nga koka. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Arben Gashi e ka fjalën për këtë çështje.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë normalisht që e dënoj gjuhën e përdorur nga ish-Avokati i Popullit dhe po ashtu shpreha solidaritetin me grupet parlamentare duke u ngritur këmbë në shenjë proteste për gjuhën e përdorur.

Megjithëse unë besoj dhe jam i bindur që ky problem nuk duhet të sillet në Kuvend se nuk është problem i Kuvendit. Është problem i një personi fizik i cili duhet të paditet dhe duhet të ngrihet padi ndaj atij personi për gjuhën të cilën e ka përdorur dhe t'i bartë pasojat ligjore. Ndërsa për pasojat politike për veprimin që e kanë ndërmarrë, nëse "Vetëvendosja" është solidarizuar me këtë gjuhë që e ka përdorur personi në fjalë, atëherë "Vetëvendosja" e merr pasojën politike, por jo t'i sjellim në këtë mënyrë problemet në Kuvend dhe të hapim tema të tjera se kush çfarë ka thënë në një kohë të caktuar. Është e paarsyeshme të sillen në Kuvend kështu problemet e rrugës, se ai është problem i rrugës, dhe ajo gjuhë është gjuhë e rrugës, nuk është gjuhë e Kuvendit, dhe nuk duhet të sillet si problem i tillë këtu.

Megjithëse unë edhe një herë po e them, e shpreha solidaritetin me kërkesën e zonjës Izmaku, por mendoj se ato probleme nuk duhet të sillen në Kuvend, sepse po degjeneron pastaj fjalë pas fjale, gjuhë pas gjuhe, dhe nuk ka asgjë pozitive prej kësaj pune. E inkurajoj zonjën Izmaku së bashku me koleget, edhe unë nëse ka nevojë i jap përkrahje që të ngrejë padi, padi civile për këtë punë, e nëse ka hapësirë edhe për padi, por jo ta sjellim si problem në Kuvend, sepse nuk është problem i Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka më diskutues. Po e shfrytëzoj rastin në emër timin, por edhe në emër të të gjithëve që t'i kërkoj falje çdokujt për çdo fyerje, edhe në emër të Sami Kurteshit, veç lutemiqë pas sodit të mos ketë gjuhë të tillë.

Nuk është marre të kërkoshe falje, por me paramendim kur bëhet...lutemi të mos ketë më gjuhë të tillë, unë s'kisha besuar kurrë që një veprimtar tillë, i madh, i çështjes kombëtare që mund t'i ndodhë, le herën e parë, por herën e dytë më ka befasuar. Por, unë po kërkoj falje, unë për vete po kërkoj falje, se ti je shumë e edukuar, po kërkoj falje për të gjithë, po kërkoj falje kudo, vetëm do të ishte mirë të mos ndodhë më. Mirë është të kërkojnë falje ata që fyejnë, se shumë ka fyerje.

Njerëz jemi, edhe në emër të kryeministrit, edhe në emrin tënd, Shqipe, që më ke sharë, edhe në emrin tënd, Donikë, që më ke sharë, por vetëm të mos ndodhë më.

Shkojmë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike mbështet propozim-vendimin që ky projektligj sot të shqyrtohet në dy leximet. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk, apo kush, Rexhep Selimi e ka fjalën, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

REXHEP SELIMI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes nuk e sheh të arsyeshme ta procedojmë një ligj kaq me nguti, prandaj nuk e përkrahim leximin e dytë brenda të njëjtës ditë të shqyrtimit.

KRYETARI: Faleminderit! Pal Lekaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e sheh këtë ligj si të ngutshëm dhe kërkojmë që kjo të shtyhet pas festës dhe derisa nuk ka një dakordim të të gjitha subjekteve, mendoj se është një nguti e madhe, prandaj ne nuk e përkrahim që të bëhen dy leximet. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Duda Balje nga “6+” e ka fjalën.

DUDA BALJE: Parlamentarna Grupa “6+” podržava predlog da se danas održi drugo čitanje ovog zakona. Hvala!

KRYETARI: Zoti Enver Hoti nga Grupi Parlamentar “Nisma”.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i “Nismës” kërkon që të mos procedohet më tutje ky projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju e dini nenin 84, s’kam nevojë ta lexoj. Duhet t’i shmangemi Rregullores me 2/3 e deputetëve të pranishëm në sallë.

Të nderuar kolegë deputetë, votojmë në mënyrë elektronike për shmangie nga Rregullorja, duhen 2/3 e kolegëve deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash për shmangie nga Rregullorja.

61 deputetë kanë votuar. 52 për. 9 kundër. Nuk ka abstenime. Kalon.

Konstatohet se Kuvendi vendosi që shqyrtimi i Projektligjit për ndryshime dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të bëhen me procedurë të përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit, sipas propozimit të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zotit Zenun Pajaziti.

Vazhdojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në parim. Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Arban Abrashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Paraqes sot para jush plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 04/ L- 261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Qëllimi kryesor i këtij ligji është kategorizimi i veteranit luftëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës sipas tri kategorive, sipas periudhave kohore gjatë mobilizimit.

Mobilizimi i parë nga viti '91 deri në përfundim të luftës. Periudha e dytë ose kategoria e dytë mobilizimi nga marsi '98 deri në përfundim të luftës dhe kategoria e tretë, mobilizimi pas marsit '99 deri në përfundim të luftës. Çka është me rëndësi të ceket me këtë projektligj synohet që ky kategorizim të bëhet sipas të dhënave dhe vetë aplikacioneve, të cilat janë bërë gjatë procesit të aplikimit për statusin e veteranit të luftës.

Ligji gjithashtu përcakton edhe lartësinë e secilës kategori, domethënë lartësinë e pensioneve, ku parashihet që lartësia e pensionit të kategorisë së parë të jetë 250 euro, e kategorisë së dytë 170 dhe e kategorisë së tretë 120. Me këtë rast plotësohen edhe kushtet kryesore, të cilat ne i kemi pasur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar që të jemi në kuadër të buxhetit prej 0.7 të bruto produktit vendor, të bëhet kategorizimi sipas periudhave dhe se ky kategorizim të kryhet deri më 31 mars të vitit 2017.

Ne në ligj nuk e kemi cekur edhe periudhën kur duhet të kryhet, por ajo vendoset me një udhëzim të veçantë ose vendim të Qeverisë, me rastin e formimit të komisionit, i cili do ta bëjë këtë detyrë.

Dy kushtet themelore janë plotësuar me këtë ligj dhe gjithashtu ne kemi paraparë që të lejohet mundësia që veteranët luftëtarë të kenë mundësi të punës, ashtu që nuk është paraparë me ligjin paraprak, por gjatë konsultimeve, pas aprovimit të ligjit në Qeveri, ne kemi pranuar edhe një letër nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, i cili përcakton edhe pasi ka lexuar draftin, i cili i ka kaluar Qeverisë, sjell edhe dy-tri shqetësime, të cilat do t'i diskutojmë tani e tutje, por edhe nëpër komisione. Ata kërkojnë që mundësia e punës të mos lejohet derisa të bëhet kategorizimi që të mos të ketë shumë të panjohura, sepse mund të ketë presion ndaj buxhetit, gjithashtu kanë vërejtje edhe te lartësia e shumës së pensionit për trashëgimtarët, sepse në ligjin aktual në ligjin bazik ajo përcaktohet me 70% të vlerës së pensionit, kurse ne kemi paraparë me projekt propozimin 250 euro.

Gjithashtu, kanë edhe një vërejtje te kategoria e tretë se ata duhet të mbajnë barrën e gjithë kalkulimit në kuadër të 0.7 % të GDP-së.

Ne do të jemi këtu edhe për konsultime shtesë, por kjo është vetëm ekspozēja e parë dhe faleminderit për dëgjim.

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Sot u shtrua këtu edhe çështja e ngutjes së trajtimit të këtij ligji në leximin e parë dhe në leximin e dytë, në fakt problemi i ngutjes nuk është problem yni, por është problem i kërkesës së Fondit Monetar Ndërkombëtar, që është kërkesë eksplicite që kjo çështje të përmbyllet gjatë këtij viti. Prandaj, në qoftë se ne e bëjmë ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, duhet ta bëjmë në fund të këtij viti, në qoftë se jo duhet të presim që bordi i Fondit Monetar Ndërkombëtar në fillim të vitit të ardhshëm, diku më 4 ose 6 janar mund të vendosë që të mos vazhdojmë më tutje të jemi në suaza të programit të fondit.

Për këtë arsye dhe ka qenë lutja jonë që ta trajtojmë këtë, të bëjmë përpjekjen maksimale që t'i plotësojmë kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të dalim prej kësaj situate. Ne deri tani dëshiroj t'ju njoftoj se kemi certifikuar rreth 46 mijë veteranë të UÇK-së, në përfundim të këtij viti kemi pasur 28 mijë e 100, të cilët kanë përfituar pensione mbi bazën e ligjit.

Fatura mujore në muajt e fundit ka qenë 5 milionë euro, që nënkupton që për 12 muaj ne për këtë, sipas kësaj fature do të kemi rreth 60 milionë euro. Me ligjin ekzistues, i cili kundërshtohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, sepse nuk është një faturë e caktuar, por është rrëshqitëse, për arsye se akoma fillojnë të certifikohen individë që i plotësojnë këto kushte të trajtohen me ligj. Me buxhetin të cilin e kemi aprovuar para disa ditësh, kemi paraparë të ndahen 38 milionë për

këtë destinim dhe ai është përfunduar dhe ky 38 milionë ka qenë i harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, sepse nuk kanë lejuar që të ndajnë ose të japin përkrahjen e tyre të kemi më shumë.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka kërkuar që ne të përcaktojmë një kriter të qëndrueshëm të ndarjes për këtë destinim. Dhe, kërkesa e tyre është që nga bruto produkti vendor të ndajmë 0.7% për veteranë, që nënkupton se në qoftë se bruto produkti ynë vendor është diçka mbi 6 miliardë euro, ne do të kemi rreth 45 milionë euro për këtë destinim, të cilat lejohen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, por jo më shumë rreth 45 milionë euro.

Në marrëveshje me Shoqatën e Veteranëve, edhe me mirëkuptimin e tyre e kemi shtirë këtë kriter në ligj, edhe unë u falënderohem për këtë mirëkuptim, mirëpo duhet të kemi pastaj kujdes që proceset brenda ligjit që kanë të bëjnë me klasifikimin të përmbledhen me këtë kriter, të cilin para nesh e ka shtruar Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Sot ne kemi marrë në mëngjes, sepse është biseduar dhe mbrëmë dhe dje mjaft shumë me ta, një vërejtje, ku ata bëjnë vërejtje në nenin 16a të ligjit, të cilin ne e kemi propozuar, në pikën 5, dhe kërkojnë që të eliminohet mundësia që veteranët që janë në marrëdhënie të punës mund të marrin 50% të pensionit. Do të thotë, këtu nuk e kemi pajtimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe ata janë eksplicit në kërkesën e tyre se në qoftë se ne nuk e bëjmë këtë, atëherë nuk e konsiderojnë që ne kemi plotësuar kriterin dhe kërkesën e tyre.

Janë edhe disa kërkesa të tjera, mirëpo nuk janë kaq eksplicite sa është kjo sa i përket 50%-shit. Tash unë dëshiroj t'ju njoftoj lidhur me konsekuencat, përkatësisht me pasojat, të cilat mund t'i ketë Kosova në qoftë se ne nuk i plotësojmë kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Ne i kemi humbur vitin e kaluar 117 milionë euro si përkrahje buxhetore, të cilat nuk i kemi marrë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe janë në pritje t'i marrim në qoftë se e plotësojmë këtë kusht. I kemi edhe 35 milionë euro në pjesën e parë të vitit 2017 që mund t'i marrim, në qoftë se e plotësojmë këtë kusht, por në qoftë se jo, do të thotë do ta humbim edhe këtë pjesë, dhe kemi 20 deri 25 milionë euro humbje të mjeteve të ndara nga Komisioni Evropian, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me të qenët ose jo në suaza të programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Pra, këto ndryshojnë edhe proporcionet e buxhetit, sepse nuk do të arrijmë që të plotësojmë të gjitha zotimet tona me buxhetin që kemi aprovuar, por edhe dëmtohem dikur për rreth 170 milionë euro, në mënyrë të drejtpërdrejtë si përkrahje buxhetore.

Po ashtu, mund të presim që do të rrezikojmë edhe marrëveshjet, të cilat i kemi nënshkruar me organizatat ndërkombëtare, edhe ato të cilat do t'i nënshkruajmë më tutje. Vlera e këtyre

marrëveshjeve është rreth 902 milionë euro, afro 1 miliard euro, janë marrëveshje ndërkombëtare për investime. Unë do t'i them disa prej tyre që në qoftë se nuk jemi në suaza të programit të Fondit, do të thotë rrezikojmë që ato t'i realizojmë më tutje. Pra, janë marrëveshje që kemi me Qeverinë franceze, me Qeverinë hungareze, me atë gjermane, me austriaken, me zviceranen, me Luksemburgun, me Bankën Botërore, me Bankën Evropiane për Investime, me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me Bankën gjermane për Zhvillim dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Tash në mënyrë specifike do të thotë, këto kanë të bëjnë në mënyrë që të jeni të informuar, sepse unë mendoj që Kuvendi duhet të jetë i informuar, me trajtimin e ujërave të zeza në Prishtinë që është një marrëveshje që e kemi bërë me francezët në shumë prej 66 milionë eurosh. Është themelimi i programit për bashkëpunim financiar me Qeverinë hungareze që është në një vlerë prej 62 milionë eurosh, është trajtimi do të thotë i ujërave të zeza këtë e thashë në Prishtinë, është sigurimi i ujit për mbrojtjen e kanalit rreth 22 milionë euro, është një program rreth tregtisë dhe konkurrueshmërisë në punë rreth 13 milionë e 800 mijë. Është marrëveshja me Qeverinë federale gjermane për asistencë, do të thotë rreth 21 milionë euro janë prapë një marrëveshje me Gjermaninë në shumë prej 47 milionë euro, është marrëveshja me Qeverinë austriake në shumë prej 30 milionë euro, është rehabilitimi i hekurudhës në shumë prej 195 500 mijë euro, pastaj janë... do të thotë, prej këtyre shumave të mëdha janë: ndërtimi i autostradës, që presim të kemi përkrahjen e BERZH-it për... pjesës së autostradës tek ne në shumë prej 193 milionë euro, do të thotë janë diku 902 milionë euro marrëveshje, të cilat ndërlidhen me të qenët, ose jo, në program të fondit.

Prandaj, janë këto arsye të cilat ne na kanë shtyrë që të insistojmë që të bëjmë ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, në mënyrë që të plotësojmë kriteret për të mbetur në suaza të Fondit Monetar Ndërkombëtar, prandaj ju kisha lutur që ta trajtojmë këtë, ta aprovojmë edhe ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. Po ashtu, ju kisha lutur që të bëjmë edhe një ndryshim, të cilin ne në Qeveri nuk e kemi propozuar, do të thotë kërkesa e fundit e Fondit Monetar Ndërkombëtar është që të heqim mundësinë që ata që janë në marrëdhënie pune të marrin 50% të shumës dhe këtë mirëkuptim e kërkoj edhe prej Shoqatës së Veteranëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Fjalën e ka kryetari i Kuvendit të Republikës, Kadri Veseli.

KADRI VESELI: Të nderuar kolegë deputetë, ju përshëndes të gjithëve! Faleminderit!
I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa,
I nderuar ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, se ka punuar më së shumti në këtë projektligj, prandaj edhe po e përshëndes veçanërisht,
Ministër i Financave,
Shumë të nderuar bashkëluftëtarë, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta,

Jemi në prag të Vitit të Ri dhe sot ndjehem shumë i lumtur, që vërtet para përfundimit të këtij viti, në këtë sesion parlamentar po e mbyllim, në fakt, sesiioni parlamentar me një vendimmarrje të përbashkët, për ata që më së shumti kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në fakt, sot ne kemi përpara vetes Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin, në fakt, të ligjit ekzistues për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryeministri i Republikës së Kosovës tashmë i tha pjesët e saj, të cilat përfshihen në ligj. Unë vetëm dëshiroj të theksoj se këto ndryshime në ligjin, amendamentimit nuk i zgjidhin të gjitha problemet e bashkëluftëtarëve tanë, për arsye se duhet edhe shumë gjëra të qartësohen në Ligjin për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po më mirë të shkojmë nëpërmjet përmirësimeve hap pas hapi, se sa ta lëmë ashtu siç ka qenë. Eliminon disa nga mangësitë e ligjit të përparshëm, i cili ka qenë dhe krijon hapësirën e mjaftueshme ligjore për një trajtim më meritot të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ajo çfarë ligjin aktual me këto amendamente, në fakt, do të ndërrohet nga ligji aktual është e re e që ka qenë edhe insistim që të ndihmohen veçanërisht bashkëluftëtarët, familjet e atyre që sot nuk i kemi gjallë. Kjo ka qenë për arsye se për ne që jemi gjallë, gjithnjë mund të marrim përgjegjësi dhe të punojmë më shumë, por ata që nuk janë gjallë është një shumë modeste e cila do tu jepet ndihmë këtyre familjeve, përkatësisht fëmijëve të tyre, deri në 250 euro. Janë diku, në bazë të kolegëve tanë bashkëluftëtarë të shoqatave, mund të jenë mbi 800 vetë të cilët nga 12 qersori 1999 e deri më tash kanë vdekur dhe nuk kanë përkujdesje të duhur institucionale.

Në të njëjtën kohë, së bashku me kryeministrin kemi insistuar që të mos krijohet eliminimi e kësaj kategorie nga tregu i punës. Po e shohim që nga mbrëmë edhe sot, kryeministri e tha, ka një reagim të cilin, sipas meje, në aspektin e logjikës ekonomike, nuk e di pse është kaq reagim i fortë i Fondit Monetar Ndërkombëtar që të mos u lejohet veteranëve 50%-shi i pagës së tyre, për arsye se përmes këtyre amendamenteve u krijohet mundësi veteranëve që shumica e tyre të punojnë në biznesin privat, jo shumë në sektorin publik, për arsye se është përcaktuar një pagë që është 250 euro. Po, kjo do të ndihmonte integrimin e tyre dhe kontributdhënies së tyre, po të njëjtën kohë edhe bizneseve private. Në qoftë se do të merrnin 50% të kontributit të këtyre pagave, të cilat i kanë në bazë të kategorizimit, do t'u ndihmonte shumë.

Nuk e di, jemi duke biseduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, që t'u krijohet mundësi, sepse është në dobi të bizneseve private që t'i paguajmë bashkëluftëtarët tanë, në mënyrën kur e kanë edhe një 50% të pagës nga kategorizimi.

Ne nëpërmjet këtij ligji i riafirmojmë vlerat e luftës sonë çlirimtare, përkushtimin, mundin dhe sakrificën e mijëra burrave dhe grave të Kosovës për liri, pavarësi dhe shtet të pavarur sovran,

por nuk do të ndalemi me kaq. Ne kemi edhe kategoritë e martirëve, do të shikojmë edhe për ta përmirësimet ligjore. Natyrisht, edhe familjet e të pagjeturve, të cilët janë një kategori bukur e madhe ende, të cilët nuk dinë fare për fatin e të pagjeturve dhe të njëjtën kohë kanë shpenzuar shumë si familje, në përpjekjet e tyre për të ditur më shumë për zbardhjen e fatit të të dashurve të tyre.

Përmes këtij ligji ne forcojmë krenarinë tonë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, evitojmë shumë disa nga tendencat të cilat kanë qëllim t'i vënë njollosje kësaj kategorie, të cilët vijnë gjithmonë jashtë Kosovës, për të treguar se veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë një pjesë aktive ende kontributdhënëse, jo vetëm në çlirimin e Kosovës, po edhe në ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Me këtë ligj ata nuk kërkojnë privilegje, por kërkojnë vetëm që të kenë edhe më shumë përgjegjësi të barabartë, si pjesë e shoqërisë. Këtë e kemi biseduar edhe me kolegët tanë nga shoqata. Unë dua t'i falënderoj ata në mënyrë të veçantë, të cilët janë lartë, kolegët e shoqatave, të cilët kanë qenë shumë kontributdhënës në këto amendamente dhe të njëjtën kohë, shoqatave të dala nga lufta, të gjitha shoqatat atëherë, të cilat kanë marrë pjesë në këto amendamente, të cilët kanë qenë në rend të parë shumë korrekt dhe janë munduar në asnjë moment mos të lejohet që të dënohet Kosova në barrën e kolegëve tanë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

I nderuar Armend, kolegët tanë të shoqatave nuk e kanë ngritur zërin në pjesën e tyre të pakënaqësisë, për arsye se ata kanë pasur vërejtje që nga rekrutimi i numrit të madh të pjesëtarëve, asnjëherë nuk e kanë ngritur zërin dhe kanë pranuar edhe kategorizimin, vetëm që mos të dëmtohet askush. Për këtë ne duhet të jemi shumë falënderues, veçanërisht atyre që janë lartë atje. Suksese! Faleminderit!

Unë i ftoj kolegët e opozitës, që ta votojnë. Është e mirë për luftëtarët tanë. Mendoni për familjet e atyre bashkëluftëtarëve që nuk i kemi sot këtu. Vetëm për ato 800 familje, në qoftë se janë, e kisha votuar.

Sido që të jetë, vendimmarrja është transparente dhe është demokratike. Partia Demokratike e Kosovës, Zenuni e tha, do ta votojë me kolegët e partnerëve të koalicionit. Suksese! Faleminderit kolegë të shoqatave! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit! Fjalën e merr, në emër të Komisionit FunkSIONAL, deputeti Hatim Baxhaku.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,
Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2016 shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'i propozojë, t'i paraqesë, këtë:

Rekomandim

Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit, edhe përkundër vërejtjeve të shumta që pati nga anëtarët e komisionit, duke besuar se në mes dy leximeve, përmes amendamentimit do të bëhet përmirësimi i këtij projektligji, vlerësoj se projektligji plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandoj Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Baxhaku! Atëherë, tani do të marrim deklaratimet e kryetarëve, ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Kush flet për Partinë Demokratike? Ju jeni disa, cili... urdhëro, Beka.

FADIL BEKA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për veteranët e luftës. Konsiderojmë se këto ndryshime janë shumë të rëndësishme, prandaj ne në parim do t'i mbështesim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Beka! Për Lidhjen Demokratike, Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike do ta mbështesë në parim këtë projektligj. Ky projektligj ka për qëllim, siç e tha edhe ministri e po ashtu kryeministri, kategorizimin e këtyre veteranëve, po ashtu ka për qëllim edhe stabilizimin e shpenzimeve për këtë kategori. Kemi edhe harmonizimin e fondit monetar me vërejtjet që u thanë nga ana e kryeministrit.

Kërkesa e Fondit Monetar është që ky projektligj të miratohet gjatë vitit 2016 dhe në parim Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike do ta miratojë dhe ftoj të gjithë deputetët, që këtë projektligj në parim ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Morina! Për grupin e “Vetëvendosjes”, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në radhë të parë dua të sqaroj diçka për ditën e djeshme, kur deputetët janë ftuar ta trajtojnë këtë projektligj, në mënyrë të padrejtë është akuzuar opozita që ka prishur kuorumin, e kur ne e dimë që grupet parlamentare të PDK-së dhe të LDK-së, të dyja bashkë, bëjnë rreth 70 deputetë, atëherë është e padrejtë të thuhet, ose të kërkohet nga opozita, që ta bëjnë kuorumin, kur një gjë nuk janë të gatshëm ta bëjnë shumica.

Andaj, dua të reagoj për një gjë të tillë, për shkak se dje kjo ka qenë e padrejtë kundrejt opozitës. Tash na paska ardhur koha që ta bëjmë kategorizimin e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sipas këtij projektligji të ardhur nga Qeveria. Nëse paska ardhur koha ta bëjmë kategorizimin, atëherë nuk do të duhej të fillohej nga një kategorizim, i cili këtë kategori e vlerëson vetëm, theksoj, vetëm si kategori sociale, sepse nëse bëhet fjalë për kategorizim, ju këtu jeni kujdesur vetëm si t’i kategorizojmë me rroga, respektivisht pensione.

Deri më sot, sidomos kjo qeveria e fundit, pa përjashtuar edhe ato paraprake, këtë kategori si vlerë e kombit shqiptar dhe e Kosovës në përgjithësi, nuk e kanë vlerësuar asnjëherë si kategori e cila ka edhe karakter historik edhe moral, por tashmë kemi përfunduar vetëm duke konsideruar këtë kategori si barrë, jo si vlerë historike. Prandaj, kjo është e padrejtë.

Por, unë dua të filloj që ky problem nuk ka filluar vetëm sot, nëse e kemi ne, shumë prej jush keni qenë deputetë edhe në legjislaturën e kaluar edhe në këtë legjislaturë sot dhe ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” kemi dhënë vërejtjet tona edhe me problemet që ka ligji bazik, nga të cilat probleme pastaj pasojnë edhe problemet që kanë vazhduar, qoftë me procesin e verifikimit të veteranëve, e kur i kemi dhënë këto vërejtje për ligjin bazik ka pasur disa njerëz që nuk kanë pritua ta konsiderojnë kundërshtimin për këto si kundërshtim për ligjin për UÇK-në.

Jo zotërinj, është e kundërta! Ne ato vërejtje që i kemi dhënë atëherë, kanë rezultuar si vërejtje të drejta, të cilat pastaj kanë rezultuar edhe si probleme për vetë organizatën e veteranëve, si probleme për vetë familjet e dëshmorëve, si probleme për vetë veteranët në përgjithësi. Por po ashtu, edhe procesi i verifikimit ka rezultuar si pasojë e mungesës së kriterëve në ligjin bazik të jetë një proces i dështuar, për shkak se gjatë procesit të verifikimit është tejkaluar dyfishi i veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pra, janë fryrë listat deri në atë masë sa që është tejkaluar dyfishi, e theksoj. Dhe, ju e dini shumë mirë këtë.

E pastaj, si rrjedhojë, Qeveria nuk paska mjete financiare ta mbështesë këtë numër kaq të madh të veteranëve, respektivisht me pensione.

Duhet t'ju bëj me dije edhe diçka, se po të ishin respektuar kriteret dhe po të ishin në listat e veteranëve ata që vërtet janë veteranë, sot do të kishte mjete të mjaftueshme që ata të kishin pensione të dinjitetshme.

Sidoqoftë, është i padrejtë kategorizimi i veteranëve në paga ose në pensione, në këtë rast, sepse cili prej veteranëve ka pasur dy shpirtra, tjetri tre dhe tjetri një që të kategorizohen sot në tri kategori. Kushdo që ka ardhur në luftë, ka pasur një shpirt. E nëse doni t'i ndani në kategori, është e lehtë. Ndani në ata që kanë ardhur për të vdekur në Kosovë dhe kanë qëndruar deri në ditën e fundit të luftës dhe ata që luftën ose pjesëmarrjen në luftë e kanë pasur si “par tajm”, herë kanë ardhur e herë kanë ikur dhe përfundimi i luftës nuk i ka zënë në Kosovë. Nëse doni t'i ndani, ndani kështu, dhe jo t'i ndani në ata që kanë ardhur para kësaj date a pas asaj date.

Unë po flas me bindje. Po flas me një të ashtuquajtur kredibilitet, për shkak se jam që nga fillimi pjesë e kësaj lufte dhe kësaj ushtrie. Pra, është shumë e padrejtë të kategorizohen ndryshe dhe në mënyrë kaq të padinjitetshme dikush që ka ardhur po ashtu për të vdekur sikur që kam qenë unë nga fillimi, ka ardhur edhe në vitin 1999 dhe ka qëndruar deri në fund të luftës.

Prandaj, ndarja e tillë është e padrejtë. Nëse doni t'i ndani, ndani ata që kanë qëndruar deri në fund të luftës në Kosovë dhe jo ata që e kanë pasur pjesëmarrjen në luftën e UÇK-së sa për të bërë një fotografi dhe për t'u kthyer në Gjermani, me një fotografi me uniformë të UÇK-së.

Zonja e zotërinj,

Ky projektligj, siç thashë edhe në fillim, është i padrejtë në vetvete, ashtu siç ka qenë i padrejtë edhe Ligji bazik për luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe sa herë i kritikojmë këto ligje, unë e di që ka kujdestar të thonë: “Këta janë kundër ligjit për veteranët”. Jo, jo! Ne që kritikojmë këto mangësi jemi për një listë të mirëfilltë që kategorinë e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ta konsiderojnë ashtu siç është, jo vetëm si një barrë financiare, por si një vlerë kombëtare, gjë që nuk ka ndodhur dhe nuk po ndodh.

Prandaj, konsiderata e tillë deri në shpërblim me 120 euro për një veteran që paska ardhur më herët a më vonë, unë mendoj se është e padinjitetshme, ndarja në kategori të tilla është e padrejtë, prandaj Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do të bëhet pjesë e këtyre mashtrimeve të radhës ndaj veteranëve, sepse po të ishte kaq e zellshme kjo Qeveri, siç duket këtu, do të mund ta respektonte edhe ligjin ekzistues, gjë që e ka shkelur në vazhdimësi.

Po të ishte kaq e zellshme kjo Qeveri që është këtu, do ta respektonte dhe do ta zbatonte edhe Ligjin për familjet e dëshmorëve, respektivisht nenin 8.2, që ka të bëjë me dëshmorët e paraluftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Po ata ju nuk i trajtoni, sepse ata nuk po mund t'i konvertoni në vota. Prandaj ky ligj, nuk po vjen sot rastësisht. Ky ligj nuk po bëhet sot rastësisht me nguti, për shkak se ju këtë projektligj, respektivisht ligj, po ia dedikoni vetëm vitit 2017, si vit elektoral.

Si të tillë, ne nuk mund ta mbështesim dhe nuk mund të bëhemi pjesë e manipulimit të radhës me vlerën ndër më të mëdhatë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, siç janë veteranët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Selimi! Deputeti Daut Haradinaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

DUAT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Mendoj se duhet ndarë në dy pjesë diskutimin kur bëhet fjalë për këtë ligj, dhe unë shumë besoj që deputetët, kolegë të mi, të paktën e kanë lexuar. Nëse e kanë lexuar këtë ligj, përgjigjen e kanë të qartë.

E para. Ky ligj, edhe një herë, pas të satën herë, është kah fut thika mes pjesëtarëve të luftës. Do të thotë, është kah tenton edhe një herë t'i ndajë për të satën herë, që është e gabueshme.

Përveç kësaj, unë besoj shumë se deputetët e LDK-së në asnjë variant nuk guxojnë të pajtohen me këtë ligj, e nëse pajtohen, e kanë shumë gabim.

Pra, kush është ajo UÇK e 1991-ës? Kush dreqin janë ata? A e di ndokush, kur... kur UÇK në 1991-ën. Armend, mos fol kur të flas. Ti e di, se e ke traditë t'i dish këto sende. Unë s'e kam.

Po nuk ka pasur UÇK në 1991-ën. Ka njerëz që kanë sakrifikuar më 1991 dhe ligji mund të bëhet i veçantë që e respekton secilën kategori, dhe jo vetëm më 1991, por edhe Isuf Gërvallën, Kadri Zekën, Bardhoshin dhe të gjithë ata burra. Po ata nuk janë UÇK.

Mundet prej Luftës së Dytë Botërore, më 1944, prej OZNA-s kur i ka pushkatuar e deri sot, mund t'i respektojmë si kategori, por jo UÇK. UÇK nuk është e vërtetë. Nëse dikush mendon se është kah harton ligj, edhe përfaqësuesit e shoqatave atje, që më parë tha dikush: "Jo, kanë ndihmuar, kanë kontribuar, kanë bashkëpunuar", e ku ta di unë. Shumë gabim keni bërë me këtë ligj, shumë gabim! Keni rënë pre e mashtrimeve ordinere të disa zyrtarëve, kushdo qofshin ata, që sot tentojnë ta diskriminojnë një kategori, për të cilën po i thonë UÇK, shoqata, veteranë. Mos harroni, more njerëz, kush janë ata veteranë! Po ata janë qytetarët tanë, populli i Kosovës.

Po edhe ata lekë nëse po shkojnë, po për herë të parë populli i Kosovës është duke përfituar nga ky buxhet. Nuk po i çojmë nëpër autostrada, nëpër "Bechtel Enka" miliardat. Përfundimisht, një herë po hyn një buxhet në popull, dhe sot po na tregon FMN-ja.

I lexoi kryeministri obligimet buxhetore që i ka marrë Qeveria e Kosovës me partnerët tanë strategjikë perëndimorë, Gjermaninë, Francën, Holandën etj. Ato janë kredi. E ky harroi të thotë se janë kredi. Harroi të thotë se ato marrëveshje janë ratifikuar në Kuvendin e Kosovës. Ato janë kredi që ne duhet t'i kthejmë paratë, është borxh publik. Na i kemi kthyer ato mjete, ndoshta janë

kredi të buta, në dakord dhe faleminderit prej tyre, dhe shpresoj që edhe në të ardhmen na i japin. Por, nuk është e vërtetë se ne po i humbim kreditë që i kemi marrë në rast se kjo do të vazhdonte njëjtë. Nuk qëndron! Mos u mundoni të më bindni mua, bile.

Ka këtu shumë ekspertë të ekonomisë se e dinë këtë. Ne e kemi votuar në Kuvend. Kjo nuk është e vërtetë.

E tash po flasim për kategorinë. Po ia bëj një pyetje, por nuk e di a është Antoni këtu a jo? Edhe Rusten e kam atje!

Kush është ai zyrtar i ministrisë dhe i kryeministrit që mund të ndajë kategorinë dhe t'i japë mandat një kategorie të luftës? Kush është ai?! Kush është ai përfaqësues i shoqatave të luftës që më tregon mua kush janë veteranë të 1991-tës, 1998-tës, 1999-tës. Kush është, qysh e ka emrin? Pyetja është shumë domethënëse. Do të thotë, Arban Abrashi do të më tregojë mua kush është veteran i 1991-ës, 1998-ës dhe i 1999-ës. Është shumë pa lidhje kjo. Nuk ndodh, vëlla, kurrkund në botë!

Këta zotërinjtë e shoqatave atje, i kanë mashtruar, i kanë gënjyer shoqatat nëpër komuna. U kanë thënë se jemi duke ua rritur pensionet në 250 euro. Po ju siguroj vetëm një send, ajo kategori që do t'i marrë 250 euro nuk do ta kalojë numrin mbi 100, në nivel të Kosovës.

Të tjerët, do t'i shtini thika popullit ndërmjet veti kush është dezertor, kush është pjesëmarrës, kush është pjesëtar, kush është veteran, kush është dëshmor, kush është martir? Ky është gabim, të cilin po e bëjmë.

Në fund të fundit, plumbi i armikut nuk e ka pyetur askënd a ke ardhur në 1991-ën, 1998-ën apo 1999-ën. Ne me të njëjtin armik kemi pasur punë. Nuk të ka pyetur as çfarë feje ke, po e ke pasur palën kundërshtuese, palën mbrojtëse vendore, në këtë rast, UÇK-në. Nuk është mirë të lejohet të ndodhë diçka e tillë.

I kuptoj dhe i arsyetoj plotësisht ndikimet buxhetore që i ka ligji, por unë i lus deputetët të mos e bëjnë këtë send, se është e gabueshme. Më vjen shumë keq, për shembull, që shkoi kryetari. E kuptoj edhe atë se është në preson të madh të FMN-së, por mos harroni, Amerika është shtet i madh, shtet i fortë, pikërisht pse s'ka FMN.

Edhe FMN-ja duhet kuptuar se nuk mund të nënshtrohem, se është një kategori shumë e madhe. Dhe, në rast se ka matrapazë që kanë hyrë e janë bërë veteranë, duhet t'i heqim, se s'kanë qenë. Jam dakord, por të mos gabojmë të biem pre e këtij ligji mashtrues, ligj ndarës, që do ta ndajë popullin, që do ta ndajë shoqërinë tonë dhe që, po ju siguroj, do të na shkaktojë probleme, dhe do të harrohen problemet buxhetore, çka do të shkaktojë në popull.

Në rast se Rustem Berisha dhe Anton Çuni pajtohen me këtë ligj, edhe unë do të votoj për.

Në rast se Adem Grabovci dhe bashkëluftëtarët e tij pajtohen me këtë ligj, edhe unë do të votoj për. Por, duhet të deklarohen, edhe shumë burra të tjerë. Nuk guxojmë! Më mirë të mos u japim hiq dhe të thoni s'kemi buxhet, mos i paguani. Por, mos bëni ndarje, bre, më. 17 vjetësh pas luftës, në fund të fundit ua kemi dhënë një kredibilitet atyre burrave dhe të mos i ngucim më.

(Ndërhyrje)

Jeni shkuar... edhe grave. Faleminderit, Arben! Ua keni ndalur pensionet e moshës. Kjo ka bërë që shumë prindër të dëshmorëve të ndahen se kush është trashëgimtar i buxhetit. Për shembull, ua keni ndalur pensionin e moshës, që është gabim. Dhe, po flitet shumë ka ndikim buxhetor. Sa dëshmorë i kemi? 2212. Asnjë më shumë e as më pak. Pse, duhet të shkaktohet kaq traumë në shoqëri. I kemi ndarë dëshmorët, për shembull, një familje që ka dhënë më shumë se një dëshmor, nuk i ka të drejtat e përfitimit. Po, është gabim, o vëlla, ajo. Imagjinoni një prind që i ka dhënë 3 djem, 2 djem. Për shembull, ai s'ka të drejtë t'i përfitojë dy. Është rregulluar me ligj, e tash po tentojnë prapë t'i ndajnë.

Këto sende, Arben, nuk duhet lejuar, pavarësisht. Kërkoj falje edhe një herë, unë e kuptoj shumë mirë edhe kryeministrin, edhe kryetarin e Kuvendit dhe e di që është shumë e zorshme, por edhe FMN-ja duhet të na kuptojë neve.

Është një kategori shumë e ndjeshme dhe nuk guxojmë të biem pre e këtij mashtrimi publik që shoqatat e reja që kanë ardhur, më vjen keq, sepse janë këtu prezentë, kanë gabuar shumë që kanë rënë në ndikim të cilitdo ministër apo kryeministër.

Dhe, herën tjetër, shpresoj se këta do t'i mbajnë fjalët që u kanë thënë atyre zyrtarëve lokalë, sepse mua po më shkruajnë SMS dhe po m'i dërgojnë me fotografi çka u kanë dërguar këta. Pra, për mua, personalisht nuk më përfaqësojnë prej sot. Këta nuk janë përfaqësues të mi, këta janë mashtrues ordinerë.

KRYESUESI: Faleminderit! Enver Hoti flet për grupin "Nisma".

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Të nderuar bashkëluftëtarë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Sot kemi përpara një projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët. Ne mendojmë dhe jemi të bindur se ky projektligj që ka ardhur edhe përpara është i papranueshëm për ne, sepse në mënyrë jo të duhur dhe me metoda aspak të përshtatshme po tenton të përçajë veteranët e luftës dhe bashkëluftëtarët tanë, duke i kategorizuar ata në mjete buxhetore apo në

pagat e tyre, të cilët i meritojnë dhe është dashur t'i marrin më herët, të kenë një trajtim tjetër nga Qeveria, e tani po tentohet nëpërmjet një ndryshimi në këtë ligj të ndahen nga ana financiare.

Ne jemi të bindur se Ligji për veteranët duhet të ndryshojë, por duhet të ndryshojë në formë tjetër, në përmbajtje tjetër, në rrethana dhe kushte të tjera, ku të gjithë ne do të jepnim kontributin tonë, e jo në formën dhe mënyrën siç ka ardhur tani.

Është absolutisht e pasaktë dhe e pavërtetë që të thuhet dhe të thirret këtu, ndoshta në një formë sikur të bëhet thirrje për lëmoshë, për ata 800 bashkëluftëtarë tanë, të cilët u tha se kanë humbur jetën nga viti 1999 e këndej.

Jo, ata mund të jenë pjesë e ndryshimeve, por jo në këtë formë duke u thirrur në ta, në familjet e tyre, të cilat kanë mbetur pa përkujdesje, pa përkujdesje qoftë nga niveli lokal apo niveli qendror dhe të futen edhe elemente të tjera brenda këtij ndryshimi apo plotësim-ndryshimi të projektligjit dhe të arrihet qëllimi aty ku duhet të arrihet, duke u thirrur edhe në ata 800 bashkëluftëtarë tanë që e kanë humbur jetën.

Po ashtu është absolutisht e papranueshme që ata luftëtarë, të cilët kanë ardhur dhe luftuar në Kosovë, e kanë kryer detyrën e vet ndaj atdheut, e tani për kushte ekonomike dhe nga fukarallëku i tyre që i ka sjellë në Qeveri, prapë janë kthyer dhe jetojnë në vende të tjera dhe ata të diferencohen dhe të mos trajtohen brenda këtij ndryshimi, kush e merr atë të drejtë, me çfarë të drejte ju mund t'i diferenconi bashkëluftëtarët tanë në formë të tillë?

Prandaj, ne ju kërkojmë ta tërhiqni këtë projektligj për ndryshim-plotësim dhe t'i qasemi edhe një herë rishqyrtimit të tërë këtij procesi, sepse u tha këtu se janë mbi 45 mijë luftëtarë, të cilët i ka evidentuar deri më tani Qeveria dhe Komisioni Shtetëror për Veteranët.

Po mendojmë që duhet të rishqyrtohet ky proces në tërësi dhe të hiqen këto elemente që i keni sjellë dhe të mos e futni këtë sherr mes veteranëve të luftës. Është absolutisht e papranueshme sa herë të ndërrohen drejtuesit e Shoqatës së veteranëve, të nxirren projektligje.

Ne bëjmë thirrje që këta që qëndrojnë këtu, të cilët i përshëndes dhe i falënderojmë për punën që e kanë bërë deri dhe të përbashkët, mos bini pre e manovrimeve politike dhe t'u qaseni detyrave të tilla, të cilat s'mund t'i bartni.

Unë jam i bindur nga ajo që kam pasur që nga dhe deri më tani me qindra bashkëluftëtarë nuk e kanë mbështetjen e veteranëve, mund ta kenë mbështetjen e strukturave të caktuara brenda veteranëve të luftës, por jo mbështetjen e veteranëve të vërtetë.

Jam i bindur në këtë, prandaj këta zotërinj duhet marrë përgjegjësinë dhe duhet të kthehen nga kanë ardhur dhe t'i bashkëbisedojmë dhe t'i bashkëtrajtojmë të gjitha çështjet së bashku me veteranët në terren, por jo me struktura të caktuara, jo me njerëz, të cilët janë futur nëpër parti politike dhe tani thirren në emër të shoqatave të veteranëve, kudo qoftë, nëpër degë, nëpër komuna apo kudo që janë.

Unë po bëj thirrje, duke kërkuar nga të gjithë deputetët të jemi syçelë dhe të marrim përgjegjësi që na takojnë karshi veteranëve të luftës që t'i kthejmë këto plotësime-ndryshime në rishqyrtim në Qeveri dhe të krijohet një mundësi tjetër për ta rishqyrtuar ligjin dhe për ta plotësuar, me ato që ka nevojë të bëhen brenda ligjit aktual për veteranët e luftës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Duda Bale për Grupin "6+".

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna Grupa "6+" podržava ovaj Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona o veteranima oslobođilačkog vojske Kosova i naravno ne možemo da sakrijemo pozitivne emocije koje imamo da se u okvir ovog spiska a nadam se u okviru ovih kategorija naših Bošnjaci koji su dali doprinos u oslobođilačku vojske Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Nuk ka grupe të tjera, tash do të flasim deputetët sipas paraqitjes. Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sinqerisht nuk dua të bëj replikë, veç po e jap një sqarim, sepse të gjithë qytetarët e dinë se çfarë ka ndodhur kur është nxjerrë ligji bazik, kush ka votuar të ndahen luftëtarët dhe kush ka qenë kundër kësaj ndarjeje? Nëse dikush nuk është për t'i ndarë luftëtarët dhe organizatat e luftës, është Lidhja Demokratike e Kosovës.

Fatkeqësisht, askush nga këta të opozitës në atë kohë nuk kanë votuar kërkesën tonë që në përkufizim, mes tjerash, të përfshihen të gjitha organizatat e luftës, qoftë Ministria e Mbrojtjes, qoftë FARK-u, qoftë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, të gjitha kategoritë dhe kjo do të ishte ai kontributi i mosndarjes. Dhe, po harrojnë, qytetarët e dinë që kjo nuk ka ndodhur.

Përkundër kësaj, ne si LDK e kemi votuar atëherë projektligjin dhe sot do ta votojmë, sepse nuk jem që veteranët e luftës, njerëzit të kanë kontribuar të mbeten pa ndihmë, pa përkrahjen siç e meritojnë. Por, të dihet para qytetarëve nuk bënë të bëhet lojë fjalësh, janë transkriptet, janë dokumentet, shkruan qartë çfarë ne kemi kërkuar në atë kohë dhe nuk jemi përkrahur po këta, nga të cilët sot flasim për mosndarjen e veteranëve e luftëtarëve e organizatave. Ku kanë qenë dje? Nuk na kanë përkrahur.

Por, po ashtu e kemi thënë vazhdimisht ne nuk besojmë që kjo listë është reale, me 46 mijë, por nuk i takon deputetit të merret me këtë. Kërkojmë nga ata që janë kompetentë të bëjnë verifikimin e listave dhe ata që e meritojnë t'i marrin këto sepse i meritojnë, jo që u falim diçka.

Por është shumë e qartë, është shumë e qartë kemi qenë dhe jemi që të përfshihen të gjitha organizatat e luftës, të gjithë ata që kanë kontribuar, sepse kjo është më e mira edhe për ligjin, edhe për veteranët. Nuk ka ndodhur, përsëri për të treguar se duhet të jemi të përgjegjshëm, ne e kemi votuar dhe do të votojmë, sepse meritojnë këta njerëz përkrahjen.

Ndërkaq ata që kanë hyrë në listë, në ç'formë kanë hyrë, organet duhet të merren, A kanë hyrë me mito, a kanë hyrë me ryshfet, a kanë hyrë me dallavere, unë nuk e di, por se nuk kanë qenë 46 mijë këtë e dinë të gjithë, por kjo u takon organeve kompetente që ta verifikojnë.

Edhe një herë po e përsëris, jemi që të ketë përfshirje të të gjithëve, të gjitha organizatat, të gjithë veteranët që e meritojnë, të gjithë luftëtarët dhe ne nuk jemi ata që i kemi ndarë asnjëherë. Ata që i kanë ndarë janë këta që sot po flasin dhe nuk na kanë përkrahur as atëherë, edhe sot po ju siguroj nuk na përkrahin në kërkesat që i kemi pasur.

Sidoqoftë, ne e votojmë projektligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Selvije Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë po shpresoj që ky plotësim-ndryshim i ligjit ka një qëllim që të ndikojë pozitivisht në një kompensim sado të ulët që u bëhet kategorive të dala nga lufta, gjegjësisht veteranëve të luftës.

Mirëpo, shpreh shqetësimin te kategoria e tretë.

Te neni 4, neni 16a, që shtohet në projektligj, që propozohet të shtohet kategoria e 3-të përfshihen të gjithë ata të cilët kanë qenë aktivë apo janë mobilizuar që nga 31 marsi '99 dhe kanë qenë aktivë deri në fund të luftës, si dhe veteranët, të cilët qoftë nga '91-shi a '98-a nuk kanë qenë aktivë deri në fund të luftës.

Unë mendoj se ata të cilët janë mobilizuar dhe kanë qenë aktivë nga 31 marsi '99 e deri në fund të luftës nuk mund të hyjnë në një kategori me ata të cilët u përkasin dy kategorive të para, por nuk kanë qenë aktivë deri në fund të luftës, pavarësisht arsyeve e të mos qenit aktivë.

Andaj, mendoj që duhet të jetë kategoria e katërt, 1.4, ata të cilët nga të gjitha këto tri kategoritë e para nuk kanë qenë aktivë deri në fund. Nuk po më intereson lartësia e kompensimit, sepse edhe ashtu nuk po kemi mundësi për një lartësi më të madhe, mirëpo nuk mund të krahasohen ata të cilët nga tre muaj kanë pritur nëpër shtetet e Perëndimit, e dimë se si kanë qenë ata jashtë, të mobilizuar për të ardhur në Kosovë, por është dashur të sigurohet rruga, është dashur të sigurohen dokumente që të vijnë deri në Shqipëri dhe t'i bashkohen luftës në Kosovë dhe nuk mund të hyjnë në një kategori me ata të cilët për shkaqe të arsyeshme kanë dalë nga lufta apo kanë ndërprerë aktivizimin e tyre në luftë dhe nuk kanë qenë deri në fund.

Shqetësimin tim tjetër e jap te paragrafi 6, që thotë: “Në qoftë se 0,7% e bruto produktit vendor nuk i mbulon shpenzimet, bëhet vlerësimi vetëm për kategorinë e fundit”. Në qoftë se nuk i mbulon shpenzimet, duhet të rishikohet mundësia e gjetjes së mjeteve. Pse? Kemi mundësi, nëse vërtet ne si popull dhe si institucione duam që kategorinë më të shenjtë të këtij vendi që sakrifikoi, por për fat të mirë mbetën gjallë dhe jetojnë, kanë familjet e tyre, t'i shpërblejmë, hajde deri sa të ngritët buxheti i Kosovës dhe bruto produkti vendor të heqim dorë nga benificionet tona si zyrtarë të shtetit. Kemi mundësi ta bëjmë këtë dhe unë jam shumë e bindur që deri në 10 milionë në vit kursehen. Fillojmë prej Zyrës së Presidentit, Gjykatës Kushtetuese, Ombudspersonit, deputetëve, Qeverisë dhe të gjitha agjencive të tjera publike, a jemi të gatshëm t'i heqim benificionet dhe t'i lëmë vetëm pagat tona? Nëse jemi të gatshëm, buxhet ka, por nëse ne nuk jemi të gatshëm, atëherë tentojmë të gjuajmë dhe të mos japim përgjigje të mjaftueshme për një kategori që është dhe që vlen të respektohet nga institucionet e vendit.

Çështja tjetër, ministri i Punës e tha që mendohet deri në mars të bëhet kategorizimi i këtyre veteranëve, kurse në ligj, neni 8 thotë: “Ministria në afat prej 6 muajsh pas hyrjes në fuqi të nxjerrë aktet nënligjore”.

Unë mendoj që afati prej 6 muajsh të shkurtohet dhe të bëhet në 3 muaj, me të vetmin qëllim që sa më shpejt të përmbushen obligimet e këtij ligji po qe se e merr votën tonë, që besoj do ta marrë.

Dhe, e kam një propozim edhe për shoqatat, që është jashtë ligjit, por është për ta, edhe për Qeverinë që të hapet një ling në kuadër të institucioneve të Kosovës dhe aty të bëhen publike të gjitha të dhënat për të gjithë të angazhuarit në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ligji parasheh nga '91-ta, në rregull, nga '91-ta deri në fund, periudhat kur kanë qenë aktivë, kur janë larguar nga lufta, kur janë mobilizuar në luftë dhe krahas kësaj të jepen edhe të dhënat të tjera detaje për të gjithë, nga cilat vende kanë ardhur, ku kanë qenë të angazhuara, në cilat misione jashtë vendit që i kanë kontribuar Kosovës dhe të gjithë qytetarët, por edhe më gjerë të dinë për secilin veteran kur është angazhuar, sa ka kontribuar dhe vërtet të kemi një pasqyrë të saktë.

Po ashtu të bëhet publike nëpërmjet lingut edhe të tjerët që kanë kontribuar dhe kanë rënë për Kosovën para vitit '91, por edhe ata të cilët kanë rënë dëshmorë dhe të gjithë ata që cilët janë edhe invalidë të luftës. Kjo me të vetmin qëllim që të dimë saktë dhe të mos manipulojmë kush çka bëri, kush kënd e përkrahu në mënyrë të pabazuar apo jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Selvije Halimi! Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Ligji për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare kur është diskutuar para dy vjetësh për afërsisht, u miratua në prag të zgjedhjeve të reja atë kohë dhe ne, edhe në atë kohë si Lëvizje "Vetëvendosje" kemi thënë që ky ligj nuk është i mirë. Megjithatë, veteranët e luftës kanë kërkuar që të mbështetet dhe ne e kemi mbështetur.

Në fakt, tash po shihet që edhe atëherë ka qenë një ligj me karter elektoral, u desh të shkojnë jo më shumë se dy vjet dhe për të kthyer në ato përpjekjet fillestare që ishin që benificionet, respektivisht pagesat, materialet për pjesëtarët e UÇK-së të shkurtohen.

Pra, zoti Veseli u përpoq ta shesë ndryshimin e këtij ligji si diçka shumë pozitive, si diçka që ndikon në të ardhurat e veteranëve të UÇK-së, si diçka që është në dobi të tyre, por është krejt e kundërta.

Atë që tha zoti Veseli unë po e demantoj me atë që kryeministri i Kosovës, zoti Mustafa, e tha në fjalimin e tij që ky ligj po ndryshon, sepse shuma që po përfitojnë veteranët e luftës aktualisht është 60 milionë. Pra, qëllimi i këtij ligji është që këtë shumë prej 60 milionësh që marrin veteranët e UÇK-së aktualisht ta zvogëlojnë, pra që kjo shumë të mos u jepet.

Derisa ligji aktual krijon njëfarë lloj stabiliteti shumë të vogël, duke garantuar paga minimale, sipas nenit 18, që i bie diku rreth 170 euro, me këtë propozim Qeveria e Kosovës dëshiron ta heqë nenin 18, pra nuk dëshiron të lejojë asnjë stabilitet të caktuar të mjeteve.

Kategorizimi, e sidomos kategoria e tretë, ku një pjesë e pjesëtarëve të UÇK-së marrin vetëm nga 120 euro, tregon që qëllimi i Qeverisë është pikërisht të ulen mjetet materiale nga të cilat do të përfitojnë veteranët e luftës.

Nuk e di a ka menduar ndokush deri tani, por shumica e veteranëve të luftës që marrin mjete i takojnë pikërisht kategorisë së tretë.

Nëse deri sot kanë marrë 170 euro në muaj, apo pagën minimale në Kosovë, kjo kategori nëse ndryshohet ligji do t'i marrë 120 euro, madje shkohet edhe më larg, duke thënë që nëse pjesa prej 0.7% nuk mjafton, atëherë kjo pjesa prej 120 eurosh mund të shkurtohet edhe më shumë.

Megjithatë, edhe ky propozim që është bërë në ligj vjen në kundërshtim me nenin 40 të ligjit aktual, i cili thotë që Qeveria e Kosovës obligohet në të gjitha rrethanat financiare t'i përmbushë obligimet financiare që dalin nga ky ligj.

Pagesat dhe benificionet për veteranët e UÇK-së nuk mund të reduktohen, po e theksoj, nuk mund të reduktohen apo të eliminohen me vendim qeveritar.

Ndërsa me propozimin që e ka sjellë Qeveria bën pikërisht këtë, dëshiron që te kategoria e tretë me vendim qeveritar të shkurtojë pjesën e mjeteve që do t'i marrin veteranët e UÇK-së.

Neni 3 i ndryshimeve të propozuara, respektivisht pika 5a thotë që veterani luftëtar i UÇK-së që jeton në shtet tjetër gëzon të drejtën në benificione të tjera sipas këtij ligji, por nuk gëzon të drejtën në pensione.

Nuk e di pse nuk na u tha arsyeja për çfarë qëllimi po bëhet ky lloj kategorizimi.

Përfashtim nga paragrafi 5a bën pjesë kjo që veterani luftëtar i UÇK-së që jeton në vendet fqinje i gëzon të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj. Tani punë po e shtroj pyetje: Në qoftë se veterani që jeton në Maqedoni, Shqipëri, Mali të Zi apo në Luginë çfarë ndryshimi ka me veteranin që jeton në Kroaci?

Ne si Kuvend, po edhe Qeveria e Kosovës po kërkon që pensionet e punëtorëve tanë që jetojnë në Zvicër të kenë mundësi të transferohen në Kosovë, t'i marrin në Kosovë.

Për çfarë arsye tani standarde të dyfishta, pse pensionet nuk i marrin qytetarët e Kosovës, pra që jetojnë në vende të tjera?

Dhe, në fund, ajo që po më pengon më së shumti që i gjithë diskutimi këtu në Kuvendin e Kosovës po bëhet në lidhje me vlerat e UÇK-së, po diskutohet vetëm rreth parave. Ky është diskutimi kryesor që po bëhet në Kuvend, pra, kur po flasim për vlerat e UÇK-së, po flasim për para.

Për mua vlerat e vërtetë të UÇK-së janë atdhedashuria, është sakrifica, është liria, mbi të gjitha është sovraniteti i vendit. Këto janë vlera themelore, por nuk janë vlera vetëm këto, të cilat ju po i përmendni. Madje, duke i kategorizuar ushtarët e UÇK-së dhe duke i mashtruar me ligje, të cilat i proklamoni sikur gjoja janë ligje të cilat u ndihmojnë ushtarëve të UÇK-së. Ndërsa, në fakt, kanë për qëllim që shumicës t'ua shkurtojnë rrogat, respektivisht pensionet.

Dhe, krejt në fund dua të lidhem edhe me atë që tha zoti Ismet Beqiri, që ne e kemi votuar ligjin, kemi qenë kundër ndarjes. Në fakt, edhe ne e kemi thënë që ligji nuk është i mirë, por ju i dini

cilët kanë qenë kundërshtarë tuaj atëherë? Tani keni hyrë në koalicion me ta, tani keni një shumicë parlamentare, urdhëroni dhe bëni amendamentet dhe futni në ligj ato që ju mendojnë që janë të drejta, e mos qani me lot krokodili sikur gjoja ju ka penguar opozita.

KRYESUESI: Të thirrni ty, ta ka përmendur emrin, ke të drejtë të flasësh.

ISMET BEQIRI: S'e di, po flasim për një ligj të rëndësishëm dhe atij nuk i bëhet pa kritikuar zakonisht, sepse ai është deputet me korrespondencë, këtu e ka problemin ai. Është me korrespondencë, vjen këtu prej Zvicrës dhe pikërisht ky është ai që na moralizon neve e derdh lot krokodili, sepse ne jetojmë këtu, punojmë këtu dhe nuk kemi tjetër formë të financimit, adresa rezervë, pasaporta rezervë. Unë jam shtetas i Kosovës dhe mburrem me këtë, nuk i kam dy pasaporta dhe të vetmen punë e kam këtë, për dallim prej këtij patrioti me lot krokodili, por vërtet më ka përmendur edhe në një seancë tjetër, për ndryshe nuk ia kisha përmendur emrin ose s'isha marrë me të fare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ta ka përmendur emrin, Faton Topalli, një minutë e ke.

FATON TOPALLI: Faleminderit, jo në fakt nuk e shoh të arsyeshme të polemizoj me zotin Beqiri, po desha t'ia bëj një korrektim, për shkak që jetoj jashtë, sigurisht që ka nja 30 vjet që jetoj jashtë dhe nuk i thonë "pasosh", i thonë pasaportë në gjuhën shqipe, ndërsa sa i përket kësaj, po mendoj që edhe Lidhja Demokratike, edhe zoti Beqiri është angazhuar shumë që mërgimtarët vijnë këtu, të investojnë, të angazhohen në jetën politike. Unë jam i vetmi mërgimtar këtu në Kuvend dhe tërë kohën më thuhet "ke pasaportë", "pse po vjen", madje kam dëgjuar zëra që më kanë thënë "çka po lyp këtu", "shko në Zvicër". Ky është vendi im, unë e dua vendin tim. Arsyeja e vetme që unë angazhohem këtu nuk janë përfitimet materiale, sepse të gjithë e dinë që përfitimet materiale janë në vendet të tjera më të mëdha, në Zvicër janë më të mëdha se në Kosovë.

Unë e kam ideal, kam dëshirë të angazhohem, prandaj po mundohej, për aq sa kam mundësi, ta jap kontributin tim. E pse kjo i pengon...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka Rustem Berisha, le të përgatitet Anton Quni.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Së pari, mendoj se ky ligj për ndryshim ka ardhur me vonesë, ka ardhur dje, edhe pse një lloj arsye na u tha që është kërkesë, por unë mendoj si zakonisht, këto ligje që janë me rëndësi po na

vinë në momentet e fundit, pa pasur kohë t'i trajtojmë mirë, t'i analizojmë mirë, të marrin pjesë të gjithë që duhet pa i kaluar dëgjimet publike e sa e sa të tjerë. Domethënë, ne vetë po i bëjmë disa gabime për ligje që janë tepër të rëndësishme.

Unë këtu sa i përket këtij ligji mendoj se duhet të trajtohet në dy faza. Faza e parë që bazohet në ligjin paraprak, në Ligjin luftës, i cili përfshin periudhën '97-'99.

Por, në këtë ndryshim që na ka ardhur propozim për ndryshim nuk shihet askund se është ndryshim i atij ligji, por tash po përfshihen pjesëtarët '91-'99. Unë nuk e di në bazë të bisedave, takimeve që i kemi pasur me Komisionin qendrorë qeveritar, zakonisht është përmendur data e vitit '93-'94 e themelimit të UÇK-së, por nuk ka datë zyrtare kur u themelua Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e tani po dalim që të përfshihet periudha '91, pa dhënë ndonjë sqarim pse dhe në çka janë bazuar, pse kanë shkuar në këtë periudhë të vitit '91.

Unë vetë kam qenë pjesë e luftës dhe e vlerësoj lart angazhimin, sakrificën dhe kontributin e të gjithë luftëtarëve të lirisë, pa dallim, dhe mendoj që në këtë drejtim duhet ta kemi të gjithë një qasje të tillë.

Por, nuk është mirë që ky kontribut tentohet të përfitohet nga ndonjë subjekt politik, kushdo qoftë.

Veteranët, të cilët kanë qenë në luftë, kanë marrë pjesë në luftë, edhe pse edhe atëherë kemi pasur probleme, edhe tendenca, edhe ndarje kur gjatë luftimeve armiku nuk na ka pyetur a je me këtë organizim apo me tjetrin, po vetëm a je shqiptar edhe a je pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe si të tillë na kanë trajtuar. Përderisa ata nuk na kanë ndarë, pse ne të ndahemi? Pse shqiptarët vazhdimisht janë të prirë të ndahen?

Është miratuar një ligj më herët, një ligj i cili i ka pasur defektet e veta, sidomos neni 3, përkufizimi nuk ka qenë gjithëpërfshirja aty, por me Komisionin qeveritar kemi arritur që të mos vërehet, që të gjithë atyre që kanë marrë pjesë u është njohur e drejta të statusit të veteranëve. Nuk ka pasur ndarje. Tani me këtë ndryshim, me këtë ligj që po tentohet, po propozohet për ndryshim është një ndarje dhe kjo ndarje parashihet në kategorizim. Unë nuk jam që ta përkrah këtë ligj në këtë formë pa u bërë disa ndryshime.

Nëse është nevoja, u tha edhe prej parafolësve tanë më herët, se një jetë e kemi pasur, një shpirt, a kam ardhur me këtë datë a me atë datë, kurrkush nuk na e ka dhënë garanci që kemi për të shpëtuar, por secili prej tyre ka mundur ta japë jetën, pavarësisht periudhën kur ka ardhur. Ndoshta do të kishte qenë më mirë që ai fond që është i paraparë të ndahet në mënyrë proporcionale për ato kategori, varësisht kush sa i takon dhe që i plotëson kushtet me ligjin paraprak. Jo të ndahen në kategori '91-'98, '98-'99 dhe '99 në përfundim, sepse kjo vërtet ka për

të na shkaktuar telashe e probleme të mëdha në terren dhe ka për të qenë shumë problem që të menaxhohet.

Komplet angazhimi jonë ka qenë që ta unifikojmë faktorin ushtarak sidomos pasluftë. Këtë e kemi arritur me këtë verifikim të Komisionit qeveritar. Por, tani me këtë ligj po rikthehet prapë në pikën zero dhe po vazhdohet, po tentohet të vazhdohet ndarja. Nuk mendoj se ky ligj duhet të kalohet në këtë formë, pa u analizuar mirë, pa u konsultuar njerëzit që duhet të konsultohen, dhe pa pjesëmarrjen e atyre që nuk kanë marrë pjesë dhe vërtet u bënë 17 vjet pas luftës e nuk guxojmë t'i japim të drejtë vetes që t'i ndajmë luftëtarët e lirisë.

Ata kanë luftuar për shtetin e Kosovës, jo për asnjë lider politik, jo për asnjë parti politike dhe si të tillë duhet të trajtohen. Unë mendoj se ky ligj si i tillë nuk është dashur të kalojë pa ndryshime rrënjësore, edhe pse ka edhe disa gjëra të mira aty për ata që e kanë humbur jetën, që familjet e tyre t'i kenë nga 250 euro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Anton Çuni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është mirë që sot po e diskutojmë këtë çështje, por si çdoherë detyra jonë e deputetëve është që për çdo projektligj t'i japim vërejtje tona dhe ky ligj në të ardhmen të jetë në dobi të kategorive, për të cilat ne sot po bisedojmë dhe po i trajtojmë. Ligji i ka disa mangësi, posaçërisht në pasqyrimin e së vërtetës në lidhje me evoluimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, strukturën komanduese, kapacitetet luftarake etj.

Posaçërisht tani kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës me këtë ligj zanafillën e paska që nga viti 1991, opinionin duhet të dijë se kush ishin bartësit apo përgjegjësit për krijimin e formacioneve ushtarake dhe nën përgjegjësinë e kujt ishin këto formacione ushtarake. Me këtë ligj prapë nuk theksohet apo nuk trajtohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Mbrojtja Territoriale, të gjitha këto nën përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës në vitet e '90-ta.

Çështja tjetër është definimi i dobët i veteranit luftëtar. Me këtë ligj prapë lihet hapësirë për të përfutur edhe ata që nuk ishin luftëtarë. Është e vërtetë se luftëtarët nuk do të mund të zhvillojnë operacione pa mbështetje politike, financiare, logjistike e tjera. Por, të gjithë mbështetësit e luftës nuk mund të jenë veteranë luftëtarë. Këto kategori duhet të trajtohen në forma të tjera.

Prandaj, ne sot e kemi numrin e ekzagjeruar të veteranëve luftëtarë. Nëse një mësues ose arsimtar do t'ua jepte për detyrë nxënësve që me vizatim apo me përrshkrim, me ndonjë hartim ta pasqyrojnë figurën e veteranit luftëtar, ata do ta paraqesin një luftëtarë të veshur me uniformë, i armatosur, dhe nën aksion normal, nën rrënoja, përballë një makinerie të fortë ushtarake. Nuk e

di pse ne deputetët e kemi aq problem që ta përkufizojmë saktë çka është veterani luftëtar, apo kush është.

Jam më se i bindur se këta nxënës nuk do ta paraqesin veteranin luftëtar me mikrofoni në dorë, në ndonjë restorant, në ndonjë aheng, në shëtitore e tjera.

Krejt në fund, në lidhje me kategoritë e veteranëve të luftës: Unë i respektoj dhe i admiroj të gjithë luftëtarët, në cilindo periudhë kohore dhe në cilindo vend. Por, më duhet të kufizohem në lidhje me veteranët luftëtarë të Betejës së Koshares. Sipas këtij projektligji, një numër i konsiderueshëm i veteranëve luftëtarë të Betejës së Koshares do të jenë në kategorinë e tretë.

Por, e vërteta është që luftëtarët e kësaj beteje nuk janë të kategorisë së tretë. Heronjtë: Sali Çekaj, Agim Ramadani, Xhemajl Fetahu, Abaz Thaçi dhe shumë të tjerë, 113 dëshmorë të kësaj beteje nuk ishin në krye të luftëtarëve të kategorisë së tretë. Ata ishin luanë në krye të luanëve. Prandaj, ashtu edhe duhet të trajtohen, me respekt dhe dinjitet. Në Betejën e Koshares forcat serbe i dërgonin ushtarët e vet për dënim, me dhunë, me presion, me kërcënim, kurse veteranët luftëtarë shqiptarë vinin vullnetarisht në këtë beteje, dhe kjo duhet të çmohet.

Të nderuar,

Po më vjen keq që këtu nuk janë përgjegjësit, zyrtarët, ministrat, por mënyra më e mirë për t'u trajtuar kjo çështje është që të pastrohen listat nga veteranët e rrejtshëm dhe jam i bindur se numri real i veteranëve luftëtarë nuk do ta rëndojë Buxhetin e Kosovës. Po ashtu, eliminoni kategoritë e luftëtarëve dhe aq sa e përballon Buxheti i Kosovës, pensionet ndajini për të gjithë veteranët luftëtarë në mënyrë të barabartë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë,

Do të ju kërkoj falje për këtë ndërhyrje për shkak të seancës, ndërkohë derisa e kishim seancën parlamentare kanë ardhur familjarët e të pagjeturve te Kuvendi dhe ka pasur një keqkuptim. Unë flas si kryetar i Kuvendit, s'kam pas fare informacion për ardhjen e tyre dhe është krijuar keqkuptimi se si institucione nuk kemi dashur t'u përgjigjemi si Kuvend, si Kryeministri, në të njëjtën kohë edhe Presidenti, me aq sa më thanë - tri institucioneve u janë dërguar, edhe deputetëve, që të dalim për të bërë nderim te monumenti, të cilin e kemi para Kuvendit.

S'kemi marrë pjesë, edhe unë thashë, por kjo është pjesë tjetër nuk dua të futem në të. Unë u mundova t'i arsyetoj, por ajo çfarë u thashë, u premtova... ata i keni në hollin e Kuvendit, ajo çfarë u premtova është se respekti i Kuvendit ka qenë çdoherë, se kemi mbajtur seancë, në të njëjtën kohë u premtova se në qoftë se kanë dëshirë, kërkesë do ta mbajmë prapë seancë - Javën e të Pagjeturve e mban Kuvendi. Kuvendi e ka bërë atë monumentin. Sido që të jetë, unë kisha

kërkuar nga të gjithë ju, në shenjë respekti, të gjithë jemi të lënduar, ata janë më së shumti të lënduar, se nuk e dinë ku i kanë të dashurit e tyre. Kisha kërkuar nga seanca, me mirëkuptimin tuaj, ta mbajmë një minutë heshtje për të pagjeturit.

Ju kërkoj që të ngriheni në këmbë për një minutë heshtje! Faleminderit!

(Një minutë heshtje)

Nderim!

Mexhite Mjaku-Topalli, fjala për ju!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është përmbushja e realizimit të të drejtave dhe të përfitimeve të kategorive të dala nga lufta, të cilët me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar ishin faktor vendimtar në sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës.

Është e vërtetë se në këtë projektligj është paraparë kategorizimi i veteranëve të luftës së UÇK-së si përfitues të pensioneve dhe beneficioneve të tjera, të cilat përcaktohen me nenin 16a. Nëse në këtë projektligj përcaktohen të drejtat për pensione dhe beneficione për veteranët e UÇK-së, atëherë pse u mohohet e drejta veteranëve luftëtarë të UÇK-së që jetojnë në shtetet tjera, në nenin 3 pika 5a, që ishin shqetësim edhe i disa kolegëve të tjerë parafolës, të cilët e cekën këtë çështje.

Atëherë, unë mendoj se edhe këta veteranë duhet të parashihen në këtë projektligj, që të jenë përfitues të pensioneve në njërin prej këtyre kategorive të parapara në projektligjin në fjalë. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Ndoshta më së paku e kemi pritur që në fundvit apo në hyrje të vitit të ri ta diskutojmë një ligj i cili për nga rëndësia sigurisht që gjithmonë do të mbetet i veçantë, por mënyra e trajtimit të tij dhe të them tendencës së monopolizimit, qoftë me luftën, qoftë me meritat, por qoftë edhe me keqpërdorimet që kanë ndodhur, sidomos këto dy vjetët e fundit pas hyrjes në fuqi të ligjit bazik, tregon që kjo mënyrë dhe kjo kërkesë për ta votuar brenda dite një ligj të tillë nuk përkon

ndoshta edhe me vetë punën dhe angazhimin që e kanë deputetët dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Unë e kuptoj shumë drejt, kam punuar personalisht edhe në aspektin financiar, edhe si anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa në çështjen e trajtimit financiar në marrëveshjet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, disiplinën fiskale dhe besoj që të gjithë deputetët janë të vetëdijshëm për një gjë të tillë, por mendoj që kjo i tejkalon këto korniza dhe besoj se ne duhet të jemi shumë të qartë dhe të fokusohemi edhe në atë që i takon edhe të vërtetës dhe eliminimit të këtyre defekteve që mos të vijnë te problemet financiare.

Ligji është dashur të ketë ndryshime përmbajtjesore, përfshirë kontributin e çdonjërit luftëtar dhe saktësisht ta definojë statusin e luftëtarit, invalidit dhe të dëshmorit. Kjo nuk ka ndodhur as me këto ndryshime, bile aneksi 16a, që flet për kategorizimin, vetëm e thellon këtë keqpërdorim që ka ndodhur në këto dy vjetët e fundit, e vazhdon në mënyrën e manipulimit tash me kategorizim dhe nuk do të definojë asgjë.

Më tutje, edhe periudha kohore do të sjellë edhe konfuzion edhe në publik, edhe në opinion edhe në shoqërinë tonë, edhe vetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pikërisht këtu dola, sepse ka qenë fat i mirë që të jem deputet në disa mandate, ndaj mendime të ndryshme edhe me njerëz që janë të luftës, edhe ata që kanë pasur përgjegjësi, por edhe këtu kam hasur në dy kategori: ata që kanë luftuar dhe e kanë parë luftën si pjesë të lirisë e pavarësisë, por edhe ata që kanë luftuar, por e kanë parë lirinë si pjesë të zhvatjes, pasurimit dhe tendencës për një monopolizim të skajshëm të asaj merite, dhe mbi të gjitha për t'i qëndruar këtij populli në qafë, që “unë të kam çliruar dhe unë bëj çka të dua me ty”, dhe ata janë edhe në mesin tonë këtu dhe dalin shpeshherë shesin moral dhe na moralizojnë.

Andaj, për të mos arritur deri te kjo ndarje, për të mos hyrë në vitin e ri 2017, unë mendoj që ne duhet të ulemi dhe t'i saktësojmë edhe ato çka i thanë disa kolegë të mi parafolës me të drejtë, që theksuan që shumë luftëtarë me të drejtë do të mbeten, apo do të kategorizohen në atë që është e pa dinjitetshme për ta. Nuk do t'i përmendi shumat, se shuma do të jetë fyese gjithmonë, derisa flasim për luftëtarë të vërtetë që kanë luftuar dhe unë mendoj që veteranin luftëtar, ashtu siç i kam trajtuar edhe disa ligje të vendeve që kanë dalë nga lufta e identifikojnë pushka, uniforma dhe emblema dhe ai duhet të jetë veteran luftëtar.

Dhe kjo po ndodh, e Kosova i ka pasur edhe specifikat e veta të luftës që nga viti '89, e të mos flasim edhe për periudhën e mëhershme, por nëse e shohim ligjin bazik - aty është një përkufizim, i cili është bërë edhe në atë kohë me përçarje të madhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, tash kush dhe si ka votuar është çështje e asaj kohe. Ne kemi menduar, kemi shpresuar që këto do të rregullohen në mënyrën më të mirë të mundshme, do të tejkalohen ato ndarje, se

për mendimin tim dhe kushdo dhe kurdo, unë kam argumente ta mbroj se kanë qenë të qëllimshme dhe vazhdojnë akoma të jenë të qëllimshme. Fatkeqësisht, edhe përgjigjen e marrim nga vetë ata që atëherë e kanë refuzuar, kanë vazhduar ta refuzojnë, por sot japin edhe nëpërmjet opinionit, edhe përmes debateve, përgjigje skandaloze, deklarative dhe njëri-tjetrit.

Kjo periudha e vitit '91, e thanë disa kolegë, unë nuk e di se si do të përkufizohet, nuk e di se cilat do të sanksionohet me ligj, sepse lidhet me nenet e ligjit bazik, unë e kam dëgjuar shpesh Nait Hasanin që e ka mbrojtur një datë të themelimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e ka mbrojtur me fanatizëm dhe besoj që ka pasur të drejtë. Asnjëherë nuk e kam gjetur mënyrë tjetër për të dyshuar në atë, por ka qenë viti 1994, dhe sot ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale Arban Abrashi e paska gjetur një datë tjetër 1991, prandaj tash nuk e di si do ta sanksionojnë këtë të drejtë me ligj dhe kush do të përgjigjet në të ardhmen, sepse ka edhe disa nene tjera që kanë përgjegjësi edhe juridike, penale nëse dikush e keqpërdor statusin e veteranit, të invalidit dhe të dëshmorit.

Ndërsa pjesët tjera, nëse hyjmë te kategoria e dytë dhe e tretë, unë nuk do të shtoja më shumë atë që e tha edhe kolegu im Anton Quni, si dhe kolegët tjerë. Veç uluni pak mendoni pesë minuta, çdonjëri që ka qenë pjesë e luftës një ditë, dy ditë, një muaj, gjashtë muaj, dhjetë muaj dhe ta definojmë qartë këtë kategorizim. Pa ngarkesa politike, as ideologjike, as partiake. A është e drejtë, a nuk është e drejtë?

Për mua është e padrejtë. Nuk duhet të ketë kategorizim. Duhet të ketë saktësim, duhet të pastrohen listat që janë të stërfryra dhe të gjithë e dinë se si ka shkuar dhe deri ku ka ecur ky proces. Për ata që e kanë pasur këtë përgjegjësi, duhet të ulen në mënyrë të qartë, t'ua bëjnë me dije të qartë të gjithëve, të mos përdoren as për vota elektorale, as për qëllime politike, as për qëllime propagandistike, por të pastrohen në mënyrën më të mirë të mundshme dhe adekuate dhe atëherë do të zgjidhen edhe problemet financiare, qoftë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, por qoftë edhe duke u ndihmuar pak a shumë atyre që meritojnë dhe të cilët me dinjitet duhet që sado kudo shteti t'u rrijë afër sikur të gjitha kategorive tjera që Kosova po vazhdon t'i paguajë, qoftë për të burgosurit politikë, apo edhe për kategoritë tjera në Republikën e Kosovës.

Unë besoj që në këtë periudhën brenda ditës nuk do të kemi mundësi që të paraqesim amendamente, e ta plotësojmë në mënyrë adekuate këtë ligj. Edhe për ata që u përmend, përkufizimet, edhe pjesën e kategorizimit, dhe kjo është e padrejtë. Besoni se do të jetë e padrejtë edhe në trajtimin e mëtutjeshëm. Mos thoni sikur sot, para dy-tri vjetëve kur kemi diskutuar, që sot i kemi 46 mijë veteranë, 29 mijë janë pjesë e pagave, apo 60 mijë janë në total pjesë e listave të cilat i ka miratuar një komision.

Keni për ta parë dhe do ta shihni se çka do të bëhet me kategorizimin, cili do të jetë kushtëzimi, cila do të jetë loja, cila do të jetë ndarja, cili do të jetë definicioni, kush ka për t'i përdorur, kush ka për t'i keqpërdorur - ata të njëjtit që i kanë bërë edhe i kanë sjellë në këtë gjendje.

Andaj, unë mendoj që Kuvendi nuk duhet ta lejojë një diçka të tillë. Duhet ta bisedojë shtruar, duhet ta bisedojë me Fondin Monetar pjesën financiare, ta ndajë atë. Unë jam për që 0,7 të jetë pjesa complete e ndarjes buxhetore, por krahas kësaj të kemi definim të qartë të të gjitha këtyre pakënaqësive dhe të gjitha këtyre çështjeve që u thanë dhe unë besoj që kanë pasur shumë të drejtë.

Ditët në luftë numërohen, shikoni ligjet e të gjitha vendeve. Numërohen me ditë, numërohen me muaj dhe ndahen në kategori dhe nuk ka periudha ad hoc të njerëzve që dikush në vitin '91, me gjithë respektin, apo edhe në '81 apo '68 e ka shkrepur një pushkë edhe deri në vitin '99 nuk ka qenë në Kosovë. E ai luftëtar që ka qëndruar në vijë të frontit, në vijë të parë, nën breshërinë e armëve tri ditë para se të përfundojë lufta, edhe keni dëshmorë që kanë ardhur katër ditë para se të përfundojë lufta, është vrarë dy ditë para se të përfundojë lufta.

Dhe, tash, definojeni ju se kush duhet të jetë veteran luftëtar, kush duhet të jetë në kategorinë e parë, kush duhet të jetë në kategorinë e dytë.

Edhe një herë, po kthehem te e para: Kjo ndarje e qëllimshme, anashkalimi i strukturave nuk ndodh në asnjë vend tjetër që e ka kaluar luftën dhe e ka kaluar procesin e lirisë vetëm në Kosovë. Vetëm në Kosovë nuk përfshihen të gjithë ata që në mënyrë ushtarake, me uniformë, por me komanda të ndryshme, kanë luftuar për lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Vetëm te ne në ligjin që quhet për vlerat e luftës nuk është Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, nuk janë Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës, nuk janë njësitë operative, të cilat nën komandë, nën këta urdhra, nuk janë pjesë e këtij ligji. Nuk është Ministria e Punëve të Brendshme, nuk është Mbrojtja Territoriale e asaj kohe deri në përfundim të luftës, qoftë edhe organizata tjera që ne shpeshherë dëgjojmë që me marrëveshje e pa marrëveshje janë bërë pjesë e luftës çlirimtare. Dhe, besoj që edhe sot edhe nesër, edhe pas tjerë që do të vijnë pas neve në Kuvend unë nuk kisha dashur që t'ua lëmë këtë temë, por mbi të gjitha as publikut, as opinionit, as luftëtarëve.

Avazi i keqpërdorimeve do të vazhdojë me këtë kategorizim. Do të jemi dëshmitarë të kohës, unë kisha dashur që mos të jetë, por dyshoj shumë dhe jam i bindur që keqpërdorimi me vlerat e luftës do të jetë pikërisht me aneksin 16.a. Por, mbi të gjitha, edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Përfundoje fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe me komisionin të neni 40.a., ku thuhet edhe ndryshimi i themelimit të një komisioni të veçantë nga ai komision tjetër, i cili i ka trajtuar të gjitha rastet.

Ata që i kanë trajtuar duhet ta marrin përgjegjësinë, edhe morale, edhe juridike. Komisioni tjetër besoj që duhet t'i takojë një kategori tjetër që është pjesë e Gjyqësorit dhe ata duhet të definojnë a është bërë keqpërdorim apo jo edhe tek atëherë vijmë edhe te kategorizimi real dhe dhënia e meritës për të gjithë ata që kanë luftuar me pushkë në dorë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Zonja dhe zotërinj,

Unë me dëshirë nuk e kisha marrë fjalën për këtë pikë meqenëse vetë i takoj kategorisë së veteranëve prej së cilës që nga paslufta nuk kam përfituar asnjë certifikatë të lindjes, asnjë vend parking, sepse kam menduar që po e kryej një obligim ndaj vendit dhe me kaq ka përfunduar.

Mirëpo, po e shoh që sot zëri i përfaqësuesve të Shoqatës së Veteranëve të Luftës nuk i përfaqëson denjësisht ata që kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për shkak se e pranon një kategorizim.

(Reagime nga lozha e sallës)

Prit, unë jam duke folur. Këta përfaqësues të shoqatave janë me siguri në kategorinë e parë që i marrin 250 euro dhe nuk brengosen për të tjerët që futen në kategorinë 120 euro. Këtu kriter është vendosur kohëzgjatja në luftë dhe nuk është marrë intensiteti i luftës.

A mund t'i kategorizoni dëshmorët në vitin '99?

Uluni aty se unë po flas!

(Reagime nga lozha e sallës)

KRYESUESI: Ju lutem! Aida!

AIDA DËRGUTI: Nuk i përfaqësoni! Prej mbrëmë unë kam marrë vazhdimisht mesazhe, porosi prej shokëve të luftës, të cilët ndihen të diskriminuar me këtë kategorizim.

KRYESUESI: Veç një moment! Mos...

AIDA DËRGUTI: Unë jam duke folur! Unë flas në emër të të gjithë atyre shokëve, që prej dje më kanë dërguar mesazhe të vazhdueshme për këtë diskriminim, që bëhet me kategorizimin. Futen në kategorinë prej 120 eurosh, e është mjerimi më i madh që në këtë vend ka ardhur puna që veteranët e luftës presin një lëmoshë prej 120 eurosh t'ua ndajë shteti i Kosovës nga Buxheti i saj.

Është krejtësisht e pakuptueshme pse futet viti '91! Kështu tentohet të rishkruhet historia e UÇK-së. Për çfarë lufte flasim në vitin '91, ku mund të jetë dikush veteran për vitin '91? Dihet qartë se cila është periudha e luftës.

(Një zë nga lart... nuk dëgjohet qartë.)

Dyzetegjashtë mijë veteranë janë... mos u thirr në emër të Adem Jashari, ulu aty! Ulu aty, mos u thirr në emër të Adem Jasharit! Sa i merr ti? A i merr 250 euro prej këtij projektligji? Në cilën kategori je? Je 250 euro...

KRYESUESI: Pauzë, 5 minuta!

* * *

KRYESUESI: I thërras deputetët që të vazhdojmë me diskutimet, të ulen në vende të veta, të disiplinohen, ta dinë pse kanë lypë mbledhje të ngutshme më së pari ata që e kanë lypë e mandej të tjerët.

Kolegë të nderuar,

Ne patëm një ndërprerje të detyruar të diskutimit, në mënyrë të pazakonshme të komunikimit të pazakonshëm, që u bë nga foltorja me njerëzit që e përcjellin, me leje natyrisht, Kuvendin. Unë besoj, që kjo s'do të përsëritet dhe s'duhet të përsëritet.

Vazhdojmë me diskutime. Ju njoftoj, se janë edhe tetë vetë të paraqitur që të flasin. Ju njoftoj, që nuk do të ketë pauzë dreke para se t'i kryejmë këto diskutime. Ju njoftoj, se duhet të mblidhemi që të bëhet votimi.

Unë nuk i them askujt ta tërheq fjalën. Ju lus që të mos i përsërisni të njëjtat gjëra, nëse keni mundësi. kjo është një lutje kolegjinale, se shumë po përsëriteni dhe pak të reja po flisni.

Fjalën e ka Haxhi Shala. Nuk është këtu. Fjalën e ka Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Zoti nënkryetar,
Zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Më vjen keq, vërtetë, që punojmë këtu në Kuvend në një atmosferë kësisoj, që me të vërtetë është bërë në njëfarë mënyre e padurueshme, por që kemi një fat të keq të jemi këtu në këtë situatë.

Së pari, ne patëm dy ngritje në këmbë krejt të palogjikshme, që s'duhet të ndodhin këtu dhe bëjnë një minutë heshtje për të pagjeturit, të cilët nuk e dimë a janë të vdekur a të gjallë. Minutë heshtjeje bëhet vetëm për të vdekurit.

Tash, këtu te çështja e ligjit që po trajtojmë. Unë thjesht, nuk e kuptoj pse ky projektligj është në Kuvend, ose thjesht, e kuptoj se është për ta zvogëluar buxhetin që ka të bëjë me këtë projektligj dhe mendoj se Ministria nuk e ka gjetur mënyrën e duhur për ta bërë këtë. Mënyra e duhur nuk është kategorizimi, te mundësia e zvogëlimit të buxhetit duke zvogëluar pensionet e veteranëve, por zgjidhja e drejtë e vërtetë është te largimi i një numri enorm të veteranëve të rrejshëm, që kanë hyrë në listat e veteranëve.

Pra, jo vetëm që ndoshta 2/3-at, siç u tha këtu, janë veteranë të rrejshëm dhe dëmtojnë seriozisht mundësinë e marrjes së një pensioni dinjitoz të atyre që kanë qenë veteranë të vërtetë, por në anën tjetër fyejnë edhe dinjitetin e një veterani të vërtetë, sepse veterani i rrejshëm bëhet i barabartë me atë të vërtetë dhe veterani i rrejshëm tash ka të drejtë të jetë edhe anëtar i Shoqatës së Veteranëve dhe nëse në këto shoqata, ose çfarëdo organizimi janë dy veteranë të rrejshëm dhe një i vërtetë, ata do të dominojnë edhe aty. Pra, kjo fyen dinjitetin, zhvlerëson jashtë mase një kontribut që e ka dhënë një veteran i vërtetë, që ka shkuar për të vdekur për lirinë e Kosovës.

Unë mendoj që zgjidhja ka qenë te pastrimi i listave, jo te kjo formë e kategorizimit, siç ka propozuar tash ministria.

Në anën tjetër, është paraparë që mund të jetë një veteran prej vitit '91. U tha këtu që në atë kohë s'ka pasur UÇK. Në atë kohë, unë ju them me përgjegjësi të plotë që ka pasur Ministri të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe ajo nuk është përfshirë në këtë projektligj dhe është e padrejtë dhe diskriminuese. S'është në rregull, që edhe një herë, për herë të tretë, të bëhet e njëjta gjë që është bërë dy herë më parë.

Dhe në anën tjetër, tash disa kritere bazike, të ligjit bazik, kanë ndryshuar me këtë projektligj të ri dhe nuk u është mundësuar të aplikojnë atyre që s'kanë pasur të drejtë të aplikojnë në ligjin bazik, që e kemi pasur deri më tash. Pra, nuk parashihet një mundësi e aplikimit për ata që s'kanë pasur të drejtë të aplikojnë në atë ligj e tash me këtë projektligj kanë të drejtë. Pra, edhe në këtë aspekt nuk është në rregull ky projektligj.

Ka edhe disa çështje tjera, që duhet të shikohen me kujdes. Po e zëmë, çfarë logjike ka kriteri që statusin, ose benefitet, që ka ky projektligj, kanë të drejtë t'i gëzojnë ata që jetojnë në Kosovë e

s'kanë të drejtë t'i gëzojnë ata që nuk jetojnë në Kosovë edhe kanë dhënë kontribut të barabartë, të njëjtë në çdo aspekt. Pse është ky diskriminim? Madje, madje, pse është një diskriminim që kanë disa të drejta ata që jetojnë në vendet fqinje e s'kanë të drejtë ata që s'jetojnë në vendet fqinje. Pra, kjo është pa asnjë logjikë dhe mendoj se s'duhet të jenë pjesë e këtij projektligji.

Prandaj, kjo ka të bëjë thjesht me nenin 3, paragrafi 5a dhe 5b, unë mendoj se duhet të hiqen nga ky projektligj, sepse edhe një herë fyejnë, ndajnë, kategorizojnë, ata që kanë dhënë një kontribut të barabartë në çdo aspekt për aspektin e luftës në Kosovë.

Pra, janë këto çështje që duhet të rishikohen, madje edhe te neni 40a te paragrafi 1, duhet të shihet, të ndryshohen këto çështje, sepse nuk janë në rregull edhe në këtë projektligj.

Pra, nëse ministria ka menduar që me këtë kategorizim ta zvogëlojë buxhetin, është qasje e gabueshme. Është dashur të pastrohen listat dhe ajo do të ishte mënyra e vërtet, që ata që vërtet kanë qenë në luftë dhe kanë kontribuar ta marrin kontributin që u takon, e jo që ky tash me kategorizim ky kontribut i 2/3-ve të veteranëve të rrejtshëm tash u jepet përsëri atyre. S'ka asgjë të re këtu dhe nuk zgjidhet asnjë problem. Nëse 60% të veteranëve në listat që kanë hyrë janë të rrejtshëm, ata po e marrin kontributin, edhe financiar, edhe moral, edhe patriotik të atyre që vërtet kanë qenë në luftë dhe kanë kontribuar.

Prandaj, unë mendoj që me këto zgjidhje, me këto propozime, nuk janë bërë zgjidhjet e duhura dhe mendoj, se së paku këto korrigjimet minimale duhet të bëhen këtu, në mënyrë që ne ta përkrahim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëritet për ministrin!

Përsëritet për kolegët deputetë!

Një përsëritje e veçantë u shkon të gjithë përfaqësuesve, këtu që janë, të organizatave të luftës dhe të gjithë veteranëve dhe invalidëve të luftës.

Unë nuk dua ta zgjas dhe po përpiqem të jem sa më i qartë. Realisht besoj, se nuk ka mënyrë më të mirë për ta përmbyllur vitin, se sa të diskutohet një ndryshim-plotësim të Ligjit për veteranët e luftës dhe kjo është, besoj, ajo çfarë është edhe obligim, detyrim, po besoj se është edhe punë humane.

Së dyti, dëshiroj të theksoj atë që të gjithë e dimë, ligjet nuk janë, as kuran, as bibël. Ligjet plotësohen dhe ndryshohen. Ne e dimë se para dy vitesh e kemi miratuar një ligj, pastaj jemi

duke e rishikuar dhe sigurisht, se edhe në të ardhmen do ta rishikojmë. Sigurisht, se do të rritet në bazë të asaj se si rritet buxheti i Kosovës, do të ndryshojë dhe do të plotësohet.

Esenca është që ne me këtë propozim për ndryshim të këtij projektligji i arrijmë së paku dy çështje që janë fundamentale, mendoj, për veteranë dhe invalidë të luftës dhe për të gjithë ata të cilët kanë qenë pjesë ose mbështetës të kësaj lufte.

E para, vlerësojmë punën e tyre që të dakordohemi, dhe e dyta, te ata veteranë të luftës dhe bashkëluftëtarë tanë, të cilët nuk janë gjallë tash, ta kenë një kompensim familjet e tyre.

Sigurisht se kjo është një e arritur që do të duhej të çmohej dhe të vlerësohej, së paku për këtë do të duhej që ne të mbështesim këtë ligj.

Ne e dimë që, sikurse në çdo organizatë tjetër, edhe në këtë Parlament, ata të cilët i përfaqësojnë, zgjidhen me vota të lira e të fshehta.

Edhe përfaqësuesit e organizatave të luftës janë zgjedhur në këtë mënyrë dhe janë ata të cilët e përfaqësojnë, pra nuk janë të emëruar, por të zgjedhur, dhe gjithsesi ata duhet respektuar edhe në këtë formë.

Unë mendoj se në këtë fazë dhe në këto zhvillime ne do të duhej ta mbështesim këtë plotësim-ndryshim të këtij projektligji dhe të shohim në të ardhmen, në bazë të rritjes së buxhetit, në bazë të rritjes së fuqisë së shtetit, atëherë të bëjmë plotësime e ndryshime të tjera.

Kisha dashur ta ritheksoj edhe atë çfarë u tha edhe më herët se ne duhet t'i kemi parasysh edhe ata të cilët kanë rënë për Kosovën para luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe, domosdo, e dimë që është një grup, e dimë që është një komision, e dimë që Qeveria është duke kontaktuar me ta dhe institucionet e tjera, por do të duhej që gjatë vitit 2017 vërtet edhe për ta të gjendet një zgjidhje.

Mendoj se në këtë fazë do të duhej të diskutojmë dhe të propozojmë gjëra të cilat janë të mundshme për momentin, pa i vënë pikë që në të ardhmen të gjitha këto të plotësohen e të ndryshohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Kolegë të nderuar, ju njoftoj se e kam këtë regjistër: Bekim Haxhiu, Nuredin Ibishi, Hatim Baxhaku, Shukri Buja, Gëzim Kelmendi, Albin Kurti dhe tutje, Milazim Haliti, Muhamet Mustafa... Ju lutem, regjistrohuni më shpejt, se do ta mbyll listën. Pra, Haxhi Shala, e tutje... Haxhi, s'ishe ti, prandaj kjo vlen për të gjithë, mos u regjistroni nëse s'jeni këtu. Haxhi Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Kërkoj falje, isha në korridor! Unë nuk desha të marr fjalën, por më nxitën disa dhe po e marrë fjalën.

Së pari, kërkoj nga ministri që ta tërheq këtë ligj, sepse është një ligj diskriminues për disa veteranë. Po e themi diskriminues, sepse kemi një pjesë të veteranëve që pas lufte, për shkak të pamundësisë të punojnë në Kosovë, sot jetojnë në Perëndim. Dhe ata veteranë kanë qenë prej ditës së parë këtu në Kosovë.

Po bëhet diskriminimi edhe i një kategorie të njerëzve në Perëndim, të moshës, apo në pension moshe, për të cilët kur po vjen pushimi, po krenohemi, sepse po vijnë 700.000.000 euro nga Perëndimi, kurse kur vjen diçka që ata ta gëzojnë nga vendi, thonë: “Jo, ata i kanë punët mirë”.

Prandaj ata njerëz, veteranë, që kanë punuar në këtë pjesë të ligjit, dhe njerëzit të cilët punojnë në Perëndim nuk i gëzojnë të drejtat e veta, të cilat u takojnë, kjo për mua është e papranueshme dhe nuk guxoni as ju ministër e as shoqatat që të thonë se një pjesë e veteranëve, të cilët jetojnë në Gjermani e Zvicër, i kanë punët mirë dhe nuk duhet t’i gëzojnë ato...

Ligji bëhet për kategori, pa marrë parasysh ku jeton. Prandaj, kërkoj nga ju që ajo pjesë të korrigjohet, edhe pse ky ligj, për mua, është një ligj diskriminues për një pjesë të veteranëve, të cilët sot nuk janë në Kosovë.

Përveç kësaj, shfrytëzoj rastin të them se, edhe për njerëzit e moshuar e të cilët punojnë në Perëndim dhe të cilëve u është ndalur pensioni i moshës, edhe atyre t’u jepet, sepse ata kanë kontribuar më shumë se ti, se unë e shumë të tjerë nga Perëndimi për vendin tonë, e jo të thuhet: “S’u takon”. Ai nuk është duke e marrë pensionin nga buxheti ynë, është duke e marrë pensionin nga buxhetet e atyre vendeve ku jetojnë.

Pse nuk po ua llogarisim mërzinë që e kanë pasur ata për vendin. Pse nuk po ua llogarisim kontributin që e kanë dhënë për vendin, çdoherë kanë paguar këtu, nuk i kanë marrë kurrë këtij vendi. E sot po jepen 100 euro apo 50 euro nga Buxheti i Kosovës, dhe thuhet se nuk kanë nevojë.

Dhe nëse bëhen këso ligjesh, ne do të jemi kundër, edhe kundër këtij ligj.

Kërkoj nga shoqatat, edhe nga ju, ministër, ta tërhiqni këtë ligj, ta ktheni në Qeveri, ta rishikoni edhe një herë së bashku, ta bini në Parlament, të na jepet kohë për diskutim dhe atëherë do ta krijojmë një ligj të mirë. Jo sikur ligjin e parë që e kanë sjellë brenda dy-tri ditësh, të njëjtin sikur ky, vetëm sa për votë. E pastaj, eu, çka u bë?!

U bë, se vetë kryeministri i atëhershëm thoshte se edhe ai që e ka dhënë një gotë uji duhet të jetë pjesë e këtij ligji. Dhe, tash po mundohet të pastrohet me këtë... nuk pastrohet me këtë formë të ligjeve.

Pra, kërkoj nga ju, ministër, të mos vijë më e keqja dhe tërhiqë ligjin. Mos i ndaj veteranët në kategori. Veterani është veteran. E thanë edhe parafolësit e mi. Po, ta zëmë, ai dëshmor që ka rënë të njëjtën ditë, që ka qenë i angazhuar, a është dëshmor sikur ai që ka luftuar një muaj dhe ka rënë pas një muaji.

Të lutem, tërhiqë ligjin, mos bëni kesi dallimesh. Dhe, ju shoqatat e veteranëve, nuk guxon t'ua merrni të drejtën bashkëluftëtarëve tuaj që sot nuk jetojnë në Kosovë.

Kush e ka bërë këtë element, kush e ka futur këtë element në ligj, e ka bërë një gabim jashtëzakonisht të madh. Ju i njihni mirë bashkëluftëtarët tanë që nuk kanë mundur ta gjejnë vendin pas lufte në Kosovë për të punuar, sot i ke në Perëndim dhe sot u mohohet e drejta. Me çfarë të drejte? Ti, bile, Nasim, i njeh shumë mirë një pjesë të madhe të bashkëluftëtarëve tanë që janë në Perëndim dhe e di mirë çfarë kanë bërë ata njerëz, e sot të thuhet me ligj t'u cenohet e drejta për të marrë pagën ose një diçka që u takon. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,

Na erdhi edhe një projektligj tjetër me nxitim, edhe një urgjencë. Natyrisht, për shkak se nuk ekziston as hulumtimi, as studimi paraprak për qëllimet dhe objektivat e tij.

Dhe, kam përshtypjen që diku çdo i treti projektligj që na vjen neve në Kuvendin e Kosovës praktikisht është plotësim-ndryshim.

Kjo tregon që jo vetëm ligji në Kosovë, por edhe legjislacioni si i tillë është në masë të konsiderueshme arnim.

Pra, shpesh kemi dëgjuar teksa thuhet që shteti i Kosovës është shtet i ri, mirëpo kështu i bërë gjithë arna-arna, disi po del se është shtet i vjetër.

Pra, një shqyerje atje, një shqepje këtu, një shtjerrë këtu, një vrimë atje dhe të vrapojmë me nxitim që ta gjejmë një arnë përkatëse, e cila disi na e mbulon rrobën.

Pra, nuk ndërtohet shteti kështu, nuk bëhet as drejtësia, as drejtësia sociale, as zhvillimi e progresi me projektligje të këtilla, me ç'rast shumë shpejt mandej edhe duhet të vijjnë ndryshime e plotësime urgjente, por gjithsesi të pafundme.

Prandaj mendoj se ka pasur mjaftueshëm kohë, por jo edhe mjaftueshëm dëshirë që kjo të bëhet me kohë. Dhe, problemi është që urgjenca e nxitimi i këtillë shumë më tepër është që një kategori shoqërore të anashkaluar t'i organizohet një si lloj, siç është thënë në kohën antike, cirk e bukë, ku natyrisht më shumë ka cirk se bukë, dhe pakënaqësia e tyre sadopak të amortizohet.

Kjo kategori shoqërore pa dyshim se ka nevojë për mbrojtje sociale dhe ajo ka kontribuar shumë për Kosovën, mirëpo, në anën tjetër, e gjithë kjo ka të bëjë me dinjitetin kombëtar të të gjithë neve. Në masën sa ne i respektojmë dhe i nderojmë veteranët dhe invalidët e luftës, ata që kanë kontribuar e sakrifikuar, në atë masë ne jemi të vendosur që të ecim përpara asaj rruge.

Qeveria e Kosovës tradicionalisht veteranët e luftës i ka konsideruar shumë më tepër si problem politik, si problem social, se sa si zgjidhje kombëtare, siç ata janë e do të duhej të ishin edhe në dokumente, edhe në veprimet e institucioneve.

Po, është fryrë numri i veteranëve dhe nuk ka qytetar që nuk e di këtë gjë. Por, bindja ime është se ankesat e qeverisë nuk janë të sinqerta për fryrjen e numrit të veteranëve. Sepse, vetë Qeveria nuk është e interesuar që të spastrohet lista e veteranëve prej luftëtarëve të pasluftës, sepse jo pak prej tyre që tash janë në këto lista të fryra, janë të shpërblyer me histori të rrejshme, për dëgjueshmëri partiake ose janë edhe miq të afërt të Qeverisë. Në Kosovë ka shumë biografi të rrejshme dhe Qeveria, për të arritur ndikim e vet, ka fabrikuar këso biografish të rrejshme, me ç'rast, instancat e caktuara, autoritete të caktuara janë legjitimuar në mënyrë popullore nëpërmjet këtyre biografive të rrejshme dhe, natyrisht që tash atyre u duhet statusi i veteranit ose një status tjetër.

Është lënë anash historia kombëtare dhe janë fabrikuar biografitë e rrejshme personale, natyrisht në kuadër të këtij privatizimi të madh të pasluftës, ku ti s'ke më histori të popullit, po ke biografi personale, e biografi personale në kuadër të këtij lloj privatizimi natyrisht që janë të fabrikuara.

Në vitin 2011 Qeveria, për shkak të premtimeve e qëllimeve elektorale e pati prishur marrëveshjen me FMN-në, duke degraduar statusin asaj prej "stand by" në "monitoring", mbani në mend. Pra, këtu nuk është çështja se prishemi me FMN-në ose jo, por për çka prishemi me FMN-në. Dëgjueshmëria ndaj FMN-së nuk ka qenë asnjëherë absolute, por pse prishesh me FMN-në? Aso kohe për qëllime e premtime elektorale të rritjes së pagave edhe u prishëm me FMN-në.

Unë nuk besoj që 5, 6 dhe 7 marsi 1998 duhet të jetë datë që na ndan. Epopeja e UÇK-së nuk do të duhej të përdorej në institucionet e Kosovës edhe në politikën tonë askund për diçka që ndan njerëz, sepse ajo është data kryesore përbashkuese.

Mendoj që pas 28 Nëntorit, që është edhe i 1442-ës, edhe i 1912-ës, edhe 1997-ës e kështu me radhë, pas 28 Nëntorit, ne e kemi Epopenë e UÇK-së 5, 6 dhe 7 marsin, le të jetë kjo një datë e cila gjithmonë na bashkon, edhe askund nuk përdoret për të ndarë.

Unë nuk besoj që është e ndershme që sot të bëhet thirrja në UÇK-në e në Adem Jasharin kur flitet për paratë. Është dashur që edhe organizatat e dala nga lufta të insistojnë për UÇK-në dhe për Adem Jasharin kur është shkruar Kushtetuta, kur është lexuar Deklarata e Pavarësisë. Aty është braktisur UÇK-ja, aty është braktisur Adem Jashari dhe njerëzit nuk e kanë ngritur zërin atëherë. E tash të thirren në UÇK-në e në Adem Jasharin, kur bëhet fjalë për shuma të parave, unë nuk mendoj që i bëjnë nder as UÇK-së, po as vetë atyre, që besa.

Ka dallime të mëdha edhe mes veteranëve edhe mes luftëtarëve. Ka luftëtarë që kanë bërë vetëvrasje prej skamjes, ka luftëtarë që sot janë në skamje e janë shumë të varfër, edhe ka super të pasur që nuk dinë as ku t'i fshehin paratë që i kanë, këto janë dallime shumë të mëdha. Po, në luftë kanë qenë njerëzit bashkë, por ajo ka qenë para 17 vjetëve dhe, rrjedhimisht, edhe interesat sot janë të ndryshme. Veç vëreni disa veteranë e disa luftëtarë, qofshin në politikë ose jashtë kësaj, veç shikojani fotografinë e viteve të '90 edhe sot, një numër i konsiderueshëm i kanë nga 30 kilogramë më shumë, përveç asaj që e tha Aida që kanë rroba "firmato" tash. Domethënë 17 vjet janë shumë, gjithë respektin për kontributin, mirëpo populli e ka fjalën e urët fenomenale: "5 minuta para vdekjes munesh m'u koritë", kurrë nuk është vonë të koritesh.

Pra, edhe sentimente që ekziston në popull është karshi edhe gjërave të pasluftës, sepse një farë mënyre ti e rikuptimëson luftën tënde, nuk është e çuditshme mandej që dikush të thotë ty: "Nuk e paske pas për mua, po e paske pas për vete", kur sheh gjithë atë pasuri.

Unë nuk di a keni qenë ndokush prej juve në të pame për këta që kanë bërë vetëvrasje, janë 45 ushtarë të UÇK-së.

Unë kam qenë në 3-4 raste në të pame, veç po jua përshkruaj një situatë. Kur hymë në oborr aty të asaj shtëpie ku ushtari kishte bërë vetëvrasje, ishin nja 10-15 fëmijë veç në xhemperë, s'kishin jakne, asnjëri prej tyre ishin kthyer prej shkolle, aso xhemperësh në nuk ka më, aso që gjyshja dikur na i thurte me kërrabëza, tash gjithçka një euro, gjithçka 2 euro, s'po thuren më asi xhemperësh, të trashë si tepih, si qilim.

Edhe hymë brenda aty ku ishte shtëpia e të ndjerit, kishte shporet, kishte një tigan, ishte një grua aty që këtyre fëmijëve që kishin ardhur prej shkollës, në bukë bajat, një spec të cilin e kishte

pjekur në shporet ia fuste në bukë e ia jepte fëmijës. A e dini çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se ka bukë bajatë, ka spec, po nuk ka vaj, edhe pse e ka tiganin. Hymë brenda aty në të pame, ishin burrat duke folur edhe u ndjenë keq. A e dini pse? Se kishin qenë duke folur, atë drurin në oborr ku e ka varur veten luftëtari, qysh janë zakonet shqiptare, a bën a nuk bën ta prenë? Kjo kish qenë biseda, dhe kur u ulëm aty kish gotë uji sikur kjo, po gota e ujit ishte e thyer, e plasur, kur na u thyente ndonjë gotë para 30 vjetëve, ne e ruanim, po unë nuk di më kush ruan kësi gotash, po ata e ruain edhe gotën e plasur.

Shtëpia ishte e palyer edhe brenda, jo veç jashtë. Kur kemi dalë prej aty kam hyrë në makinë, i thashë shoferit, një aktivisti, a bën ta lëshosh ngrohjen, sepse mua më mërdhinë këmbët? Tha: “Po, e lëshuar është”. I hoqa këpucët, i kisha çorapet qull, a e dini pse? Se në atë qilimin që ka qenë aty në të pame nuk ka qenë fare me dysHEME, ka qenë drejt e në tokë edhe ka thithur lagështinë, unë s’e kam vërejtur që qilimi ka qenë me ujë e mua m’ishin bërë çorapet ujë. Varfëri e jashtëzakonshme, por nuk e shoh sot lidhjen mes udhëheqësve të organizatave të dala nga lufta dhe atyre familjeve ku ata kanë bërë vetëvrasje. Edhe mjafton një anëtar i familjes të thotë: “Shiko, shoku yt ku ka mbërri, edhe ai ka qenë luftëtar sikur ti, keni qenë bashkë në istikam, po ai i zoti, ai u bë ministër, i zoti ai, u bë deputetë, qe ku ke mbetur ti”. Dhe, mandej, ju e dini se te shqiptarët e varfër ka më shumë marre se zemërim.

E ka nevoja të mëdha në këtë vendin tonë, por nuk ka empati e solidaritet, më shumë ka lojëra politike edhe këtë ligj projektligj

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kryeje!

ALBIN KURTI: E kemi më shumë për interesa të tilla politike.

Dhe, krejt në fund, në shpjegimin që bëhet për këtë projektligj thuhet që projektligji bën kategorizimin e veteranëve në luftën sipas kontributit të tyre në luftë. Pra, vetëm koha si masë vlerësuese, nuk mendoj që është në rregull. Koha natyrisht që duhet të jetë masë vlerësuese, por jo e vetmja masë vlerësuese, dhe thuhet që veteranët ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës, faktorë vendimtarë.

Ne kemi dëgjuar këtu edhe prej deputetëve, edhe prej Qeverisë që faktor vendimtar ka qenë Ahtisari, disa thoshin që faktor vendimtar ka qenë NATO-ja. Problemi është ne nuk e kemi një histori siç duhet. Prandaj shtetndërtimi i Kosovës ka kaq shumë të meta.

Viti 1991, viti 1993, vitit 1994 e kështu me radhë, sepse këtu brenda ka njerëz që mendojnë që faktor vendimtar ishte NATO-ja, që faktor vendimtar ishte Ahtisari, ndërkohë që këtu po shkruan

faktor vendimtar për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë të popullit të Kosovës ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës, çfarë unë besoj.

Mirëpo, nëse ke përplot kësi rrëfimesh, ti nuk mund të kesh shtetndërtim. Një popull është i fuqishëm në masën që ka gjëra të padiskutueshme, e në Kosovë është bërë gjithçka e diskutueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne po diskutojmë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, gjegjësisht për luftën tonë.

Unë mendoj që Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk i takon më asnjë individ, asnjë grupi, por është një vlerë kombëtare dhe kjo duhet të trajtohet, vlerësoj unë, në këtë formë, dhe për këtë kanë të drejtë jo vetëm deputetët, po çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të thotë fjalën e vet, ta thotë të vërtetën mbi ushtrinë, themelimin, zhvillimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne, për mendimin tim, këtu më tepër po merremi me pasojën sesa me shkakun. Shkak i gjithë kësaj që ne po merrem sot, ne e dimë se në ligjin bazik nuk e kemi të dëshirueshmen. Ka pasur deformime, këto plotësim-ndryshime që kanë ardhur vlerësoj se është një përpjekje pozitive për të ndryshuar diçka pozitive, për të bërë një zgjidhje më të avancuar. Por edhe kjo, për mendimin tim, nuk i plotëson nevojat, prapë nuk është arritur ajo që duhet të arrihet dhe në të ardhmen e afërt jo shumë të largët ne prapë do të jemi të detyruar të merremi me plotësim-ndryshimin e këtij ligji. Gjithsesi ne biseduam këtu për luftën tonë, lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka pasur një komandë, është udhëhequr nga një shtab dhe kjo ka përfunduar dhe të gjithë kemi luftuar nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe jem krenuar me të dhe vërtet meriton që të krenohet çdo qytetar i Republikës së Kosovës se i ka sjellë çlirimin.

Duhet ta kemi parasysh se përpjekjet e popullit tonë, sakrificat kanë qenë të vazhdueshme që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e deri në themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës për mua është sublimim i të gjitha atyre sakrificave, por njëkohësisht edhe përfundim i suksesshëm.

Prandaj, unë mendoj që ne jemi para dy rrugëve. Këtu po dëgjoj fjalë që me të drejtë nëse i kemi vërtet nga zemra, se ndjejmë dhimbje për kategoritë e luftës që janë në gjendje të mirë, askush nuk mund ta kontestoj këtë. Po a duam të vazhdojmë t'i lëmë në atë gjendje apo duam të bëjmë përpjekje që në përputhje me mundësitë tona, me realitetin tonë, me rrethanat që i kemi aktualisht të bëjmë një zgjidhje.

Prandaj, unë mendoj që ne duhet të bëjmë përpjekje që për këtë moment të pranojmë këtë zgjidhje jo të dëshirueshme, jo meritore, por një zgjidhje për momentin që në të ardhmen e afërt, kur të na krijohen kushtet edhe më të mira, atëherë të bëjmë zgjidhjen edhe më të drejtë, edhe më adekuate.

Prandaj, unë për këtë arsye i jep mbështetje këtij ligji, me qëllim dhe me shpresën e madhe që në të ardhmen e afërt, po e përsëris, që ky ligj duhet të korrigjohet dhe duhet të plotësohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Nuredin Ibishi.

NUREDIN IBISHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë,

Së pari e di që është një kohë e shkurtër për të bërë një ndryshim substancial apo përmbajtjesor në projektligjin që na është afuar, pra plotësim-ndryshimet, por sido që të jetë unë i kam, shkurtimisht dua t'i them, disa propozime, e këto janë në rend të parë që vetë në titullin e projektligjit këtu duhet të përfshihen, edhe përveç domethënë titullit Projektligji për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtarët e familjeve të tyre. Ky propozim vjen duke iu referuar praktikave të vendeve që kanë kaluar luftën sikur Kroacia, Bosnjë e Hercegovina dhe mendoj që familjarët janë të përkufizuar edhe me ligjin bazik lidhur me anëtarët e familjes së ngushtë, për arsye se ata edhe i gëzojnë disa të drejta gjatë jetës së veteranit, por edhe i trashëgojnë disa të drejta edhe pas vdekjes së veteranit.

Çështje tjetër për të cilën unë kisha dhënë propozim apo eventualisht Komisionit Funkcional një amendament që kjo sikur u kategorizua në tri kategori, për të cilën është për mua, nëse merrem me atë çka edhe parafolësit, zoti Zemaj e të tjerë thanë që nëse fillimi i formimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe vetë aspekteve operacionale apo luftarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe vetë përkufizimit ligjor në ligjin bazik, pra kur të flasim për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, atëherë përfshin periudhën 1997-1999, pra nuk është viti 1991. Nëse mbetet në formën çfarë është, atëherë duhet të plotësohet edhe përkufizimi edhe me strukturat që përfshihen në atë kohë, edhe këtu unë menjëherë kisha thënë se aty duhet të hyjnë se veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është qytetari i Kosovës ose shtetasi i huaj, i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar deri më 12 qershor '99 si ushtar i armatosur dhe i informuar nga komandat, shtabet operative, zona operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Ministria e Mbrojtjes së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme me Sindikatën e Policisë, Mbrojtja Territoriale, i cili aktivisht ka marrë pjesë në luftë deri në përfundimin e saj.

Mirëpo unë jam i një propozimi me një amendamentim të tij në dy kategori.

Kategoria e parë, po flasim çdo herë duke iu referuar periudhës 1997-99, jo kësaj periudhës së mëhershme nga viti 1991.

Pasi që lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës një pjesë ka qenë luftë vullnetare, nga vullnetarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra periudhën në kategorinë e parë e propozoj që të jetë apo e bëj si propozim-amendament që nga 1 janari i vitit 1997 deri në përfundim të luftës, pra ata kanë qenë vullnetarë, të jenë si kategori e parë.

Ndërsa kategoria e dytë do të vinin veteranët e mobilizuar që kap kohën nga 31 marsi i vitit 1999 deri në përfundim të luftës. Ky është, pra, një propozim konkret.

Çështja tjetër për të cilën gjithashtu kisha marrë kohë dhe kisha propozuar është që këto, pra dy kategori, jo tri kategori sikur që u tha.

Edhe aspekti tjetër është që kategoria e parë sikur që përshkruhet në projektligj, pra që pensioni mujor i veteranit në kategorinë e parë është 250 euro, që vjen mbi nivelin e kategorisë së shtatë apo atë 20 deri 30% në kategorinë e parë, domethënë një veteran i kategorisë së parë merr më shumë se një invalid i luftës, çka nuk ka kuptim. Mendoj që kjo duhet të zbresë në një masë që të jetë nën të.

Çështja tjetër, për të cilën gjithashtu kam vërejtje, është edhe çështja e ndarjes së veteranëve, të cilët kanë marrë pjesë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si ceket këtu në dy paragrafë, ku thuhet se: “Veteranët, në nenin 3, ka të bëjë me nenin 16 të Ligjit bazik, te paragrafi 5a, veterani i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që jeton në shtetin tjetër gëzon të drejtën në beneficione të tjera sipas këtij ligji, por nuk gëzon të drejtën në pension”.

Mandej paragrafi 5b, përjashtimisht nga paragrafi 5a, luftëtari i UÇK-së që jeton në vende fqinje i gëzon të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj. Mendoj që është diskriminim në këtë aspekt, se ata kanë ardhur të gjithë nga jashtë dhe s’mund t’i ndajmë a janë të vendeve fqinje apo janë diku më larg, për arsye se ata kanë pasur qëllimin e njëjtë dhe të përbashkët.

Pra, mendoj se me këto propozim-ndryshime sa do të miratohen është vështirë të them se është kohë shumë e shkurtë dhe janë të kufizuara në amendamentim.

Mendoj që ky projektligj duhet të miratohet, kemi qëllime të mira që kjo të shkojë krahas edhe mbajtjes në përkrahje të vazhdueshme jo vetëm të programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, por edhe programeve të tjera zhvillimore për të cilat u thanë. Edhe ne nuk guxojmë në asnjë mënyrë t’i humbim pra këto beneficione apo këto donacione të këtyre fondeve, pra jo vetëm të FMN-së, por edhe të shteteve donatore të tjera.

Pra, gjithashtu do të ketë parasysh edhe aspektin përfundimtar, pra 0.7% sikur që është dhënë me ligj, të mos kalohen shkaqet e dhëna në projektligj dhe kjo të përfshijë zvogëlimin linear për 3 kategori që janë përshkruar në projektligj, jo vetëm të dëmtohet kategoria e tretë, pra përfutuese e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ibish! Sa e lodhni veten për arsye time, nëse s'i bëni amendamentet, mbetet veç e shkruar në letër. Kaq. Shukrije Bytyqi e ka fjalën, Bekim Haxhiu le të bëhet gati.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues, nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Të nderuar kolegë deputetë, Të nderuar familje të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe familjeve të pagjeturve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, urime 30 dhjetori, Dita e veteranëve.

Shpreh nderin dhe respektin tim për sakrificën, gjakun dhe djersën tuaj për lirinë e Republikës së Kosovës.

Mendoj se institucionet e Republikës së Kosovës nuk kanë bërë aq sa kanë mundur për shtresën më të rëndësishme të shtetit tonë, për kategorinë më të ndjeshme, për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Se sa është i rëndësishëm ky projektligj që ne sot e kemi për diskutim shihet edhe pamja këtu që nuk e kemi as kryeministrin dhe as ministrat varës, me përjashtim të një ministri. Domethënë për këtë Qeveri nuk është e rëndësishme që të krijohet një ligj i mirë për invalidë dhe veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne dje kemi pritur rreth 7 orë që të na vijnë amendamentet e plotësim-ndryshimit të Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë kisha pyetur Qeverinë e Republikës së Kosovës, a është ky një tregim që të lexohet edhe t'i thuhet një përmbajtje, apo ne dëshirojmë që ta bëjmë një ligj të mirë që veteranët tanë t'i gëzojnë të drejtat ashtu siç i meritojnë ata?

Kjo formë qysh ka ardhur këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës është e papranueshme për ne.

Ne jemi dëshmitarë të asaj se kemi edhe dëshmorë që i kanë lënë gratë dhe fëmijët e tyre në mërgim dhe janë dëshmorë, duke filluar prej Kumanovës e plot të tjerë. Kemi veteranë që kanë ardhur dhe kanë dhënë kontributin e tyre dhe janë kthyer prapë dhe është e papranueshme që ata sot të mos trajtohen në këtë ligj. Nuk është me rëndësi ajo se sa përfitojnë ata, po edhe ata t'i gëzojnë të drejtat, të njihen më dinjitetshëm, kur ne e dimë se mërgata jonë përveç që ka ardhur

këtu dhe ka luftuar me pushkë në krahë, ata kanë qenë edhe financierët më të mirë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj, kërkojmë nga ministri dhe Qeveria e Republikës së Kosovës që ta tërheqë këtë projektligj, të mos i sjellin të gjitha gjërat e rëndësishme dhe projektligje të rëndësishme në mënyrë kaq të shpejtë, se një projektligj i kësaj rëndësie të veçantë nuk mund të trajtohet brenda natës, pse të vijë përgjithësisht brenda natës ose në prag të festave? Ne jemi në gjendje të presim pas festës, jo gjithnjë me arsye se po bëmë ndesh me Fondin Monetar Ndërkombëtar, çka është kjo? Tri javë nuk mbahen seanca, mandej thirren në mënyrë të përsheptuar. Për ne kjo është e papranueshme, prandaj kërkojmë nga ministri që ta tërheqë këtë projektligj.

KRYESUESI: Bekim Haxhiu e merr fjalën, Milazim Haliti të bëhet gati.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të cilët sot po diskutojmë këtu për të rregulluar një çështje që është jetike për ta.

Edhe më herët për këtë çështje kam diskutuar, e në veçanti një nga diskutimet e mia të para në mandatin tim të parë ka qenë kërkesa për të pasur ligjin për vlerat e luftës, për të rregulluar çështjen e familjeve, dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe ushtarëve të zhdukur.

Më në fund, në mandatin e kaluar kemi arritur të votojmë ligjin edhe për dëshmorët dhe invalidët dhe, së fundi, pastaj edhe për veteranët.

Mendoj se ligji ekzistues është një ligj i mirë, i cili e rregullon këtë fushë, mirëpo në procesin e verifikimit të veteranëve kanë ndodhur keqpërdorime dhe abuzime, të cilat tani janë të njohura për gjithë opinionin.

Ne të gjithë e dimë se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka filluar në Prekaz, Drenicë, dhe tani të gjithë e dimë që këto listat e publikuara, e dimë që gjatë luftës shumica e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo pjesa dërmuese e tyre ishin më e madhe në Drenicë, kurse zonat e tjera për qëllime të caktuara politike kanë arritur që këtë numër ta shumëfishojnë, ta rrisin.

Ne e dimë që edhe nga regjistrat, të cilët i kanë pasur zonat, në veçanti TMK-ja, kemi pasur një regjistër prej afro 20 mijë veteranëve në kohën e TMK-së. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se në kohën e luftës, kur ishte e nevojshme të jepet kontributi për atdhe, ne kishim 20 mijë, afro 20 mijë veteranë, ndërsa tani për të zhvatur janë bërë 65 mijë.

Prandaj, mendoj që të gjithë ata që kanë qitur nënshkrimin e tyre në këto keqpërdorime, duhet të përgjigjen para ligjit dhe inkurajoj Prokurorinë që të vazhdojë.

I nderuar nënkryetar,

Pasi që ky ligj po lexohet me procedurë të përshpejtuar, kërkoj që të gjitha propozimet tona, sa i përket ligjit, të merren si amendamente, për shkak se koha jonë për të dorëzuar amendamente tanimë është limituar dhe ato, ku përmenden saktësisht me nen dhe me paragrafin e caktuar. Prandaj, po kërkoj që në shërbim të kësaj komisioni që parashihet me këtë ligj, në nenin 40a, Komisioni për kategorizimin e veteranëve luftëtarë të ketë edhe kompetenca dhe të quhet Komisioni për kategorizimin dhe riverifikimin e veteranëve luftëtarë. Me këtë ligj themelohet Komisioni për kategorizimin dhe riverifikimin e veteranëve. Ky komision do t'i marrë të gjitha aplikacionet një nga një për të bërë kategorizimin, pasi që do ta bëjë këtë kategorizim, njëkohësisht le ta shfrytëzojë mundësinë që ta bëjë edhe një riverifikim dhe aty ku ka elemente të abuzimit, t'ia procedojë tutje Prokurorisë.

Gjithsesi, unë shpreh mirënjohjen time për shoqatat e veteranëve, që edhe një herë dëshmuar se janë të gatshme për të bërë edhe më shumë për vendin dhe ato pruan këtë kategorizim me qëllim që Kosova të mos humbë nga projektet e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Kjo duhet të shihet me pozitivitet për ata, por gjithsesi me këtë projektligj po rregullohet edhe një çështje shumë e rëndësishme, çështja e familjeve të veteranëve të vdekur pas luftës. Për të mos pasur më edhe rrëfime, çfarë u tha nga kolegët këtu, e që e thanë për demagogji, që tentuan ta imitojnë Migjenin dhe që nuk e duan asnjë veteran të jetë në gjendje të mirë materiale, po të gjithë veteranët i duan ashtu me lecka, ndoshta edhe të vetëvrarë. Atëherë, ata nuk mbajnë dert as për fëmijët që kanë mbetur, sepse ky projektligj rregullon edhe çështjen e fëmijëve të veteranëve që kanë vdekur pas luftës. Këtu po na mbajnë mend ose po duan të shesin mend disa për moral, që janë koritur moti dhe po duan me këtë ligj të bëjnë politikë.

Ata që janë koritur moti, të mos na kallëzojnë këtu rrëfime për moralizime e gjëra të tjera. Janë koritur, le të rrinë aty, e kanë të mjaftueshme dhe të mos bëjnë politikë me veteranët. Ne kemi kërkuar ligjin për vlerat e luftës. Para disa muajsh e kemi pasur edhe këtu në Kuvend dhe është kundërshtuar. Atëherë, për cilat vlera po flasim sot këtu?

Nëse ne si Kuvend s'kemi qenë të gatshëm që 17 vjet të votojmë një ligj për vlerat e luftës, po ky ligj për veteranët, familjet e dëshmorëve, invalidët, ky ishte dashur të jetë një nga ligjet e para të këtij Kuvendi. Ne po flasim 17 vjet pas. Faleminderit prej shoqatave që kanë gjetur mirëkuptimin me ministrinë, që të mos humbim nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, por mendoj se është detyrimsht e nevojshme që ne brenda vitit 2017 t'i rishikojmë të dy ligjet, edhe Ligjin për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës dhe veteranët dhe të bëjmë një ligj tamam si duhet për këtë kategori, duke e parashikuar edhe të ardhmen, se si do të funksionojë ky ligj në shërbim të atyre qytetarëve që kanë dhënë më së shumti.

Çështje tjetër, që është dashur të saktësohet në projektligj është pensioni i veteranëve. Fillimisht, mendoj që fjala “pension” duhet të zëvendësohet me fjalën “benificion financiar” dhe jo vetëm në këtë ligj, por edhe te Ligji i invalidëve dhe familjeve të dëshmorëve, sepse ne po u japim një benificion financiar këtyre kategorive për kontributin, të cilin e kanë dhënë në luftë dhe nuk mund të krahasohet ky benificion i tyre me pensionin e moshës. Nuk është ky pension i moshës, as nuk është pension i daljes nga puna, por është një benificion material, financiar që po e japim për këtë kategori, e në veçanti për atë kategori, e cila vërtet është në gjendje jo të mirë materiale.

Çështja tjetër, u tha nga disa kolegë për pensionin e tyre që janë jashtë, apo benificionet financiare që sot jetojnë në Perëndim. Unë e falënderoj një nga bashkatdhetarët tonë, kontributdhënës që më dërgoi një mesazh që jeton në Zvicër dhe më tha: “Unë ju lus, që kategorinë e atyre që jetojnë në Perëndim mos t’i futni në benificione financiare, sepse jemi të detyruar për ta lajmëruar atë benificion financiar për shembull në shtetin e Zvicrës, dhe atë benificion financiar që ne e marrim nga Kosova duhet ta lajmërojmë në Zvicër edhe atë na ndalet atje, e kemi zbritje pastaj në buxhetin e Zvicrës dhe nga buxheti i tyre. Veç e dëmtoni kot tha këtë Buxhetin e Kosovës të varfër, sepse ne nuk mund të shfrytëzojmë më shumë mjete”.

Prandaj, të jemi të kujdesshëm, të mos tentojmë të bëjmë politikë, ose këtë projektligj ta kthejë në vota dikush për vete. Ky projektligj duhet të shërbejë për ata qytetarë që vërtet kanë nevojë, e një kategori e madhe e tyre veteranëve vërtet kanë nevojë për një mbështetje, për një benificion financiar. Kërkesa ime është që edhe te neni 16a, paragrafi 5, mendoj që është formuluar gabimisht, duhet një formulim më i mirë, sepse këtu thotë: “Pas aprovimit dhe hyrjes në fuqi këtij ligji, veteranët e luftës së UÇK-së do të kenë të drejtë të punojnë, por në atë rast nuk do ta gëzojnë pensionin e plotë, por vetëm 50% të shumës së paraparë sipas nenit 16 të këtij ligji”. Po veteranët kanë të drejtë të punojnë, qysh s’kanë të drejtë të punojnë, por mendoj që është dashur pak më mirë të rregullohej.

Mendoj siç është propozim-amendamenti im: “Veteranët e UÇK-së që janë në marrëdhënie pune mund ta marrin 50% të shumës së paraparë sipas nenit 16 të këtij ligji”. Jo që ne t’ia caktojmë me ligj kanë të drejtë, sepse të gjitha ligjet ua mundësojnë atyre që kanë të drejtë që të punojnë, veç formulimi është bërë i gabueshëm, pavarësisht asaj që kërkesa e kryeministrit ishte kjo, mendoj që të mos jetë ky paragrafi 5, mendoj që ne duhet që ta kemi në shërbim paragrafin e pestë në shenjë kontributi për të gjithë ata veteranë, të cilët kanë dhënë për lirinë e vendit.

Unë kërkoj edhe një herë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Përfundoje!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Jam në përfundim. Kërktoj që vërtetë çështja e verifikimit dhe kategorizimit tani të përfshihet në amendamentin 40a, dhe që ne të fillojmë edhe procesin e verifikimit të veteranëve, sepse mendoj që të gjithë ata që dëshirojnë vërtetë t'i ndihmojnë kategorisë së luftëtarëve të vërtetë do ta bëjnë me këtë amendament dhe mund të jetë në shërbim të tyre.

Përndryshe, mundësia për të abuzuar me procesin pastaj çdoherë do të mbetet e hapur. Faleminderit!

KRYESUESI: Milazim Haliti e ka fjalën, bëhet gati Shukri Buja.

MILAZIM HALITI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministër,

Derisa jemi në leximin e parë të propozimit për ndryshimin e ligjit bazik për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, unë mendoj që përveç propozimeve që janë bërë për ndryshim kemi arsye të plotë që tani të mendojmë dhe për përkufizimin e nenit 3 të ligjit bazik, në të cilin nuk është përfshirë periudha, respektivisht veteranët e luftës të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Mbrojtjes Territoriale.

Besoj meqë jemi në fazën e ndryshimeve duhet edhe ky nen të plotësohet dhe të ndryshohet. Ndërsa, përveç vërejtjeve që u dhanë edhe më parë, edhe unë bashkëngjitëm me kolegët tjerë deputetë që dhanë vërejtje të diferencimit që bëhen për veteranët e luftës dhe atë ndryshimi ekziston në atë në mosgëzimin e të drejtës vetëm për nga vendi se ku tani ai jeton. Veterani i luftës që jeton në një shtet tjetër nuk ka të drejtë në pension, ndërsa veterani tjetër që jeton në shtetin fqinj e ne dimë se cilat shtete fqinje janë të Kosovës, ai e gëzon të drejtën. Unë nuk e di te propozimi, propozuesi i ligjit çka ka pasur parasysh në këtë drejtim dhe si mund të diferencohen dy veteranë që kanë qenë ndoshta në një zonë operative, në një vendluftim, në të njëjtën kohë dhe njëri e gëzon të drejtën e pensionit, ndërsa tjetri nuk e gëzon.

Unë mendoj që paragrafi 5a duhet të hiqet. Besoj që edhe kolegët tanë deputetë, që dhanë propozime dhe vërejtje do t'i harmonizojnë këto dhe në formë amendamenti do t'i propozojmë dhe në leximin e dytë. Besoj që do ta kenë parasysh dhe do të miratohen.

Përndryshe, sa u përket listave është një punë e Komisionit shtetëror, është një punë e veçantë që të gjithë ne po pajtohemi se lista e veteranëve duhet të korrigjohet. Ata që s'kanë qenë veteranë dhe luftëtarë të mos ekzistojnë në ato lista, sepse pikërisht ata e rritin atë barrën financiare të Qeverisë për t'i përmbushë të gjitha ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shukri Buja, përgatitet Muhamet Mustafa.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Të respektuar veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Të nderuar qytetarë.

Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët kanë qenë në proces që nga paslufta të çështjeve rregullative për ta rregulluar çështjen e statusit të veteranëve, i dinë mirë dilemat që kemi pasur që në kuvendin e parë të organizatës së veteranëve. Me orë të tëra na ka marrë diskutimi nëse janë për të hyrë në Organizatën e Veteranëve të të mobilizuarit, apo jo. Një pjesë e arsyetoi mjaft mirë se ai që ka ardhur në luftë edhe një ditë para përfundimit të saj ka mundur të vritet. Kishim bashkëluftëtarë, të cilët ishin vrarë pas mobilizimit dhe shtrohet dilema a janë ata dëshmorë, apo s'janë. Në qoftë se këta që janë mobilizuar nuk janë veteranë, atëherë si mund të jenë ata dëshmorë.

Thotë, kjo dilemë ka ekzistuar në atë kohë, edhe pse është diskutuar shumë gjatë, janë përfshirë të gjithë ata që ishin të angazhuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës deri në përfundim të luftës, pa e dalluar me ditë apo muaj. Po ashtu kanë qenë dilemat edhe më të mëvonshme se kush përfshihet, sidomos pjesa e logjistikës, dhe vështirë ka qenë e dalluar ushtari i njësiteve të logjistikës dhe ata që na përkrahën në logjistikë. Po ashtu, dilemat kanë qenë me institucionet, të cilat i ka formuar Shtabi i Përgjithshëm me vendime të veçanta.

Unë e kam pasur fatin të jem pjesë e komisionit edhe në formimin para se të aprovohej ligji, ku jemi munduar me një rregullore, e ka udhëhequr po ashtu i emëruari nga Qeveria, Azem Sylja, i cili më vonë dha dorëheqje që ta rregullojmë këtë çështje para se të hyjmë te ligji, por fatmirësisht u aprovua ligji dhe u bë Komisioni qeveritar i emëruar nga Qeveria.

Po jua shpjegoj pak a shumë se si ka rrjedhur te komisioni, sepse si po shihet jeni të panjoftuar totalisht. Komisioni qeveritar i ka pasur përfaqësuesit apo komandantët e zonave, dhe ata që s'kanë ardhur nga komandantët e zonave e kanë dërguar të emëruarin me nënshkrimin e tij në komision. Komisioni, secilën zonë e ka udhëhequr përfaqësuesi ose komandanti i zonës dhe e ka formuar komisionin e zonës. Komisioni i zonës i ka formuar komisionet e brigadave, komisionet e brigadave në shumë raste i kanë formuar komisionet e batalioneve dhe nga kjo hierarki është varur me ditë të tëra, me muaj të tërë, madje u krijuan pastaj edhe vite të tëra derisa u verifikuar.

Dhe ishin 17 vjet pas luftës në verifikim dhe ka qenë shumë i vështirë verifikimi. Ajo që dëshiroj, e theksova - një rrjedhë logjike që ka ndodhur atij ligji ka qenë i paqartë në shumë raste, ka qenë ushtar i uniformuar dhe i armatosur në veteran luftëtar. Ju lutem, unë kam pasur eprorë të lartë të zonës që kanë udhëhequr një sektor, i cili ka qenë, s'ka marrë kurrë armë, nuk është armatosur kurrë dhe s'ka bartur kurrë uniformë. Po harroni që gjatë luftës pjesën bukur të madhe të ushtarëve nuk kemi mundur t'i uniformojmë, sepse s'kemi pasur uniforma, kemi pasur

ushtarë. Unë kam pasur ushtarë në njësitin një, skuadër me një 12,7 mitraloz të rëndë, shtatë ushtarë të ngarkuar me 12,7, sepse në aspektin operativ është dashur 12,7 të lëvizet për shkak se është identifikuar edhe e kanë goditur në pozicionin që ka qenë. Ata kanë pasur për detyrë që të lëvizin nga një pozicion në tjetrin dhe një ushtar s'ka mundur ta bartë, meqë kanë pasur vetëm revole.

Edhe shumë specifika tjera, në të cilat nuk dëshiroj të hyjë tutje, por po hyj te çështja e këtij ndryshim ligji që po ndodh. Me keqardhje më duhet t'ju them se këtu po mbahen fjalime patetike dhe patriotike, pikërisht nga ata që e aprovuan buxhetin para disa ditësh. Neni 24 që e kam tërhequr vërejtjen e kufizon në 38 milionë fondin dhe ju lutem, Qeveria s'po bën kurrgjë tjetër, pos veprime për ta harmonizuar ndryshimin e ligjit me kufizimet, të cilat i keni vendosur ju bashkë me mua, pavarësisht si ka votuar. Po kurrgjë s'po bën tjetër, pos po mundohet ta harmonizojë atë 38 milionëshin, të mos tejkalojë dhe po më vjen keq që në paragrafin e dytë menjëherë e kemi hequr ne me ligjin bazik të buxhetit, e kemi hequr nenin 18, e neni 18 në Ligjin e veteranëve thotë: "Pensionet e veteranëve nuk mund të jenë nën pagën minimale". Paga minimale është 170 euro dhe tani kur e tërheqja vërejtjen të mos i japim mundësi Qeverisë që t'i ulë këto, apo ta ndryshojë këtë nen, që ju e keni votuar.

Dhe, tash Qeveria ka mundësi që ta ulë tarifën në 120 euro, madje edhe më pak se 120 euro. E dini se gjithmonë kur vijmë te ligjet edhe thirrmi në të jashtëzakonshme, diçka vijmë te ato, po thonë "ndërkombëtarët na kanë sugjeruar, kemi kufizime ndërkombëtare, u bë kiameti". Fondi Monetar Ndërkombëtar e di shumë mirë Qeveria, ata që kanë qenë në komuna e dinë që lëshohet një qarkore buxhetore, ku vendosen tavanet për komunat.

E njëjta formë është nga Fondi Monetar Ndërkombëtar që sugjeron, rekomandon dhe i vë do tavanet të cilët nuk bën që t'i tejkalojmë, thotë Fondi Monetar Ndërkombëtar. Por, sugjerim dhe rekomandim që ne normalisht duhet ta respektojmë për aq sa mund ta respektojmë. Nga aspekti i Fondit Monetar Ndërkombëtar, nga vetë kryeministri, nga Qeveria po thonë 0,7% e bruto-produktit vendor.

Të nderuar deputetë,

Në qoftë se nuk jeni të informuar, e keni nëpër portale, shikoni sa është bruto-produkti vendor. Në vitin 2016 bruto-produkti vendor ka qenë 6,2 miliardë, në 2017 planifikohet në bazë të rritjes buxhetore, atë buxhetin e madh që e kemi bërë, pritet të jetë në bazë të kësaj trendi, që unë dyshoj, në 7 miliardë. Urdhëroni përpjesëtojeni me 0,7% dhe e shihni që buxheti për veteranët duhet të jetë 45 deri 47 milionë, dhe 45 deri 47 milionë e kishin mbuluar pa asnjë problem, pa asnjë ndryshim ligjor çështjen e pensionit të veteranëve të luftës.

Është cekur që u mbulua, Qeveria duhet të angazhohet që ata që po e keqpërdorin fondin, që po punojnë në organizata private apo në ndërmarrje private, që t'i zërë se i kanë inspektorët e punës,

që t'i dënojnë dhe t'i dërgojnë nëpër gjykata dhe t'ua ndalë pensionin. Janë një pjesë e atyre që po e shfrytëzojnë, që janë jashtë, po i shfrytëzojnë pensionet atje, marrin paga bukur të majme edhe jashtë. Janë, do thotë këto që Qeveria i ka për detyrë me inspektorët e punës. Po ashtu, në qoftë se një deputet këtu deklaron dhe thotë me pompozitet "ka fryrje të listave, ka manipulim të listave".

Ju lutem, ju jeni deputetë dhe e dini çka do të thotë një ligj. Ju jeni të obliguar, jo me deklarata pompoze, por jeni të obliguar paraprakisht, para gjithë të tjerëve, që ta respektoni ligjin dhe në qoftë se keni një fakt, në qoftë se keni 10 fakte, urdhëroni e keni rrugën e njihni rrugën ligjore, merrni ato fakte, depononi një akuzë për komisionin i cili i ka verifikuar ato lista, qoftë për një zonë apo për komplet komisionin, sepse ndryshe nuk pastrohen listat. Jo me fjalë, jo me llafe, por me emra dhe mbiemra dhe me padi. Padi që duhet t'i bëhet komisionit me thënë këtu e ke keqpërdorur dhe atyre pastaj t'u jepet mundësia që të sqarojnë pse e kanë bërë veteranë dikë.

Dhe, ajo që unë në fund dëshiroj gjithsesi, se nganjëherë juve ju bie në mend, por ju ka rrokë sikleti a po e votoni, a s'po e votoni, unë dëshiroj që nga këtu ta shfrytëzoj rastin dhe foltoren t'u drejtohem veteranëve të luftës në ditët e tyre, në ditën e njerëzve që ishin me ndërgjegjen më të lartë kombëtare kur e ka kërkuar kombi, njerëzit që ishin më të guximshmit, që janë vlera jonë, ata njerëz, të cilët përveç guximit ditën edhe të angazhohen deri në sakrificë për lirinë e Kosovës, t'ua uroj Ditën e Veteranit. Faleminderit!

KRYESUESI: Muhamet Mustafa e ka fjalën, përgatitet Gëzim Kelmendi.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër, ministër,

Kolegë deputetë,

Unë vetëm dëshiroj të theksoj shkurt se ne rastin e aprovimit të Ligjit për statusin e veteranit apo të kontribuuesve tjerë në luftën çlirimtare kemi llogaritur se do të kemi diku rreth prej 18 mijë deri 20 mijë veta, tash kemi diku mbi 45 mijë dhe natyrisht që krijohen problemet, përballimet me buxhet të kësaj situate dhe ne duhet ta shohim si do ta përballojnë. Mendoj se ajo që kërkohet prej neve është që ne duke pasur parasysh kufizimet buxhetore, gjithsesi t'i adresojmë nevojat e veteranëve që e kanë dhënë kontributin direkt në luftë, dhe që pa asnjë dyshim e meritojnë statusin e veteranit të luftës.

Në këtë drejtim ne duhet t'u sigurojmë atyre patjetër beneficione, përfitime, pension, si të duash quaje dinjitoz, por mekanizmat e shtetit, mekanizmat e përgjegjësisë ligjore dhe sociale duhet të ndërtohen dhe të pengojnë çfarëdo abuzimi me statusin e veteranit dhe përftimin nga ai status të atyre që nuk e meritojnë.

Unë e përkrah këtë ligj, sepse ne patjetër duhet që këtë projektligj për ndryshim ta rregullojmë disi, ta përballojmë situatën me buxhet dhe unë po e shoh këtë kategorizim si një mundësi edhe dy-tri ndryshime tjera si një mundësi për përballimin e kësaj situatë me buxhetin e vitit 2017. Por, nuk jam i sigurt se me këtë i kemi zgjidhur problemet dhe në një afat të gjatë që edhe kjo do të na e zgjidhë problemin më tutje. Edhe pse ne kufizojmë situatën me 0,7 të GDP-së dhe ai kufizim mund të na krijojë probleme përsëri që duhet të kthehemi dhe t'i shohim, patjetër duhet të vijmë të ballafaqohemi me listat.

Këtë drejtim unë propozoj edhe një amendament që do ta jap me shkrim, që ndoshta është e vetëkuptueshme që organet kompetente t'i pastrojnë listat prej të gjithë atyre që kanë abuzuar patjetër, meqenëse ne duhet ta bëjmë këtë një obligim ligjor, meqenëse po e ndryshojmë këtë ligj edhe është fakt që të gjithë po e dimë se prej 22 mijë janë bërë 45 mijë duhet të shikohet ajo situatë dhe të pastrohen listat.

Prandaj, unë propozoj një amendament, neni 8a - "verifikimi i statusit dhe rregullimi i listave. Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me organizatat e veteranëve dhe organet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për t'i audituar listat e veteranëve dhe shmangur nga lista të gjithë individët që realisht nuk i plotësojnë kushtet për të gëzuar statusin e veteranit të UÇK-së".

Arsyetim

Kategorizimi krijon një situatë të re, por nuk do të zëvendësojë spastrimin e listave të veteranëve nga ata që nuk duhet ta gëzojnë këtë status, sipas ligjit. Sigurisht që unë pajtohem me shumë që thanë që duhet të shihet edhe ligji, ka mundësi që të përsoset edhe ligji, edhe natyrisht që këtë barrë mund ta marrë edhe ai komisioni që e përmendi deputeti Haxhiu këtë që e propozova tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Gëzim Kelmendi e ka fjalën, dhe i fundit është Ismajl Kurteshi. I lus deputetët që të vijnë në sallë.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër, ministër,

Kolegë dhe kolege deputetë të nderuar.

Më lejoni që edhe unë t'i bashkëngjitëm urimit për veteranët, Ditës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Debati i sotëm padyshim është një ndër debatet më të rëndësishme ngase po flasim për pjesën, për shtresën e popullsisë e cila ka kontribuar më shumti për lirinë dhe pavarësinë e këtij vendi, për ata djem dhe ato vajza, të cilët ishin të gatshëm që të sakrifikohen edhe me jetën e tyre për lirinë dhe pavarësinë që ne e gëzojmë sot.

Duke pasur parasysh kontributin dhe sakrificën e tyre, unë mendoj se me këtë ligj më shumë nuk i bëjmë mirë se sa që i bëjmë mirë. Kjo për faktin se një djalë dhe një vajzë i cili ka qenë i gatshëm ta sakrifikojë jetën të paguhet për atë unë nuk pajtohem me këtë, unë mendoj se veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk duhet të paguhen, ata duhet të shpërblehen për faktin se kanë dhënë shumë. Dhe kur jemi te pagesa, unë mendoj se edhe këto pensione, të cilat janë kategorizuar në tri kategori jo vetëm që nuk i mbulojnë nevojat e tyre për jetë, por në anën tjetër e fyejnë luftën dhe kauzën e tyre për liri dhe pavarësinë e këtij vendi. Një djalë i ri apo një vajzë e re ka nevojë nga veteranët, po flasim për ta, ka nevojë për punësim të mirëfilltë dhe ai të jetë i privilegjuar prej të tjerëve.

Do të thotë shteti duhet të jap beneficione veteranëve në punësim, të kenë punësim vërtetë merit, por jo të marrin paga duke ndenjur. Ne e dimë që një pjesë e mirë e veteranëve janë edhe të punësuar dhe në këtë rast ligji ka paraparë që për ata që janë të punësuar të marrin 50% të pensionit. Unë si deputet, fillimisht jam kundër pensioneve edhe për deputetët pensione suplementare, jam kundër edhe pagës së përjetshme të presidentit, të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, dhe kryeministrit dhe të gjithë zyrtarëve të lartë. Këtë arsye kam edhe të drejtën morale të flas që jam kundër këtyre pensioneve, ngase prapë po kthehem veteranët duhet të shpërblehen më shumë se çdo tjetër.

Nëse dikush pas luftës e meriton të shpërblehet më shumë, janë veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe jo të paguhen ata, ngase na me këtë formë me pagesat e tyre apo si është definuar me ligj, me pensione të veteranëve ne po krijojmë një shoqëri parazite ngase ata që janë duke punuar i marrin edhe 50% pension, ndërsa ata që nuk punojnë e marrin pagën pa punuar fare.

Mendoj që nuk pajtohem me këtë pikë për faktin se kjo është fyerje për luftën e tyre të shtrenjtë që kanë dhënë ata. Ata duhet të shpërblehen shumë më shumë se kjo pagë, tu jepet hapësira të ndryshme shteti duhet të mendojë për ta, qoftë në punësim, para të gjithë të tjerëve për shkak të kontributit, qoftë shkollim nëse ka nevojë, ndërsa ata që janë të moshuar normal të marrin pensionet e tyre. Unë mendoj se janë dy faktorë të cilët e dëmtojnë këtë kategori që vërtet ka dhënë shumë për këtë liri.

Në radhë të parë janë, që u përmend këtu, lista e ekzagjeruar, lista e madhe e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët pa dyshim e kalojnë një jetë të keqe, ngase është një numër tejet i ekzagjeruar që e dinë të gjithë dhe është përfolur shumë, por fatkeqësisht askush s'e ka marrë guximin ta hetojë at listë. Dhe faktori i dytë tjetër që i dëmton këta janë edhe shumë shokë të tyre, milionerë të pasluftës. Mos të harrojmë se mbi 45 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë bërë vetëvrasje pasluftës në Kosovë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, ndërsa disa shokë të tyre sot i kanë milionat. Për atë arsye unë mendoj që në radhë të parë duhet të fokusohemi në këtë pikë që ta privilegjojmë dhe ta shpërblejmë dhe jo assesi t'i paguajmë dhe të krijojmë shoqëri parazitare.

E dyta, vetë projektligji i ka defektet e veta për faktin se ka bërë një kategorizim ku përfshihet veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga viti 1991, ne të gjithë e dimë në vitin 1991 që nuk ka pasur Ushtri Çlirimtare të Kosovës, së paku publikisht, nëse dikush e dinë mirë.

E dyta, ajo çka unë e kam nëse dëshirojmë t'i përfshijmë të gjithë aktivistët për lirinë dhe pavarësinë e vendit atëherë janë shumë, janë edhe studentët e viteve të '90-ta dhe gjithë të tjerët.

Prandaj, unë mendoj që në dy fusha mund t'i kontribuojmë kësaj kategorie: këto mjete të cilat ndahen për veteranët të destinohen për familjet e dëshmorëve, për familjet e invalidëve, për familjet e atyre veteranëve që e kanë dhënë jetën pasluftës, që kanë bërë vetëvrasje pasluftës, që kanë lënë jetimë pas vetes dhe me këto mjete t'i ndihmojmë ata, ndërsa veteranëve të cilët janë shëndoshë si molla, mos t'i bëjmë parazit, por tu japim mundësi të reja, në radhë të parë punësim, kush të dojë edhe shkollim, për ata të moshuarit pensionim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot këtu u diskutua shumë, shumë deputetë folën për një ligj, natyrisht shumë të rëndësishëm, por sot këtu asnjëri nga deputetët që diskutuan nuk e përmendi një kategori që nuk kanë qenë të uniformuar, as pjesëtarë të UÇK-së, por nuk kanë qenë dhe as nuk janë më pak të rëndësishëm, se veteranët, se ushtarët, se kushdo qoftë tjetër, që ka kontribuar për këtë vend. Fjala është për veprimtarët që kanë vdekur me armë në dorë në vitin 1968, '81, '82, '84, '89 dhe krejt deri në fillim të luftës. Luftë të shpallur atëherë s'ka pasur, por luftë me Serbinë ka pasur dhe këta njerëz dhe familjet e tyre, që i kanë sakrifikuar shumë më shumë, se familjet nga '99-ta e këndeje, që janë familje të veteranëve, sepse ato familje janë maltretuar e arrestuar, burgosur e vrarë, vetëm pse kanë qenë anëtarë të familjeve të këtyre kategorive, asnjëherë, askush nuk po merret me këtë kategori.

Është hera e dytë që unë e ngre këtë çështje dhe i lus të gjithë deputetët që të mos e harrojnë këtë kategori, e cila është pararendëse e Ushtrisë Çlirimtare dhe i krejt asaj që ka ndodhur dhe që kemi arritur këtu. Ata kanë qenë në shërbim të atdheut me tërë shpirtin dhe jetën, pasurinë dhe familjen e tyre. Prandaj, kjo kategori duhet të trajtohet patjetër me këtë ligj, ose me një ligj të veçantë, sepse përndryshe u mbetemi borxh një kategorie e cila ka kontribuar shumë për që ardhur ky vend këtu ku ka ardhur në vitin '99, pra në çlirimin nga Serbia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, e dëshiron fjalën? Nuk e do.

(Ndërprerje e incizimit)

Bëhemi gati për votim, teknika dhe deputetët. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Votojmë tash! Votoni qysh të doni! Tri mundësi i keni! Sa janë pa kartela?

Deputetët kërkojnë që të votohet edhe një herë, po s'ka "edhe një herë e njëqind herë..." Prekeni për, kundër, ose abstenoni! Duhet 61 vota. Ju lutem, votoni edhe një herë!

65 deputetë janë. Votoni, teknika dhe deputetët.

(Ndërprerje e incizimit)

Zotërinj e zonja deputetë,
60 vetë tash jemi brenda. Kur do të mbledheni e të bëhemi 61 ose po e mbyll këtë seancë të paradites. Mos më shpjegoni asgjë, 60 vetë jeni, nuk mund të merret vendim, unë ua jap fjalën shefave të dy grupeve të mëdha dhe të minoriteteve. Kur do t'i bëni 61, se diskutimi mbaroi. Urdhëro, shefi i PDK-së, shefi i LDK-së...

(Ndërprerje e incizimit)

Deputetë dhe teknika, votojmë ligjin që e diskutuam gjatë gjithë kohës. Bëhuni gati, votojmë tash! Pa kartelë është një, të tjerë... i kemi 51 edhe një me dorë, 59. Votoni si të doni, unë nuk...

Atëherë, ju lutem prezencën me kartela! Regjia, praninë me kartela. Shënohuni sa jeni brenda. Votojmë tash! Sa janë pa kartela, 1. Atëherë, 60 vetë kanë votuar. 55 janë për, 1 është kundër, 3 kanë abstenuar, 1 është me dorë. Dikush s'po do të votojë...

Hajde me duar, të votojmë. Numëroni!

(Ndërprerje e incizimit)

Kundër kush është, le ta ngrejë dorën. Kundër s'ka. Kush abstenon?

(Ndërprerje e incizimit)

58 janë për. Kush është kundër? Kush abstenon? 1, 2, 3, 4, atëherë a janë 62. Pra, dikush dy herë po voton.

(Ndërprerje e incizimit)

Me ju më zgjidhje nuk kam. Zoti kryeministër, nëse e do fjalën?!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Kisha kërkuar nga ju mirëkuptimin, në rend të parë, në qoftë se kolegët deputetë që dëshirojnë të votojnë, të na tregojnë a marrin pjesë në seancë a jo. Përndryshe, për punë edhe pesë minuta a dhjetë minuta jemi 64 deputetë. Po, kush merr pjesë në votim është mirë të ulemi, për shkak të kuorumit. Është vendimmarrja e lirë kjo, kush dëshiron, vetëm se mos të kemi maltretim, se edhe administrata është duke u munduar ta...

Kuorumi, jemi duke e matur, do të shkojmë në votim me dorë. Nuk po funksionon mirë teknika shkojmë me dorë. OK, me ngritje dore, sa deputetë janë në sallë? 61. Lus kolegët deputetë, 60, Iliri edhe kështu... Danushi është duke ardhur, e zëvendëson shumë mirë Ilirin. Do të vijnë edhe të tjerët tash. Ndërkohë, po i presim edhe 3 kolegë deputetë, të cilët kanë paralajmëruar ardhjen shumë shpejt.

(Ndërprerje e incizimit)

Kolegë deputetë, në qoftë se ka mundësi t'i zëmë vendet. Përndryshe, 62 veta jemi në sallë sa po... vetëm ta vërtetojmë përfundimisht.

62 veta jemi në sallë. Pastaj, vetëm shkojmë. Atëherë, i përdorim me dorë. Fjalën kush e dëshiron? Qerim Bajrami e dëshiron fjalën, Besa e dëshironi edhe ju? Po, Besa Gaxherri pastaj. Urdhëro, zoti Qerim Bajrami fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajuću!

Samo sam hteo da kažem da građani Kosova, ceo božji dan slušaju patriotske govore vaših poslanika ovde u Parlamentu i ovde gledamo cirkus ljudi, koji izlaze i ulaze a drže svaki dan govore na televiziji o napretku Kosova i gledamo ih kako se pogađaju tamo sa vama, hoće li glasati ili neće.

Samo da znate, ovde imate 9 poslanika, odnosno 8, izvinjavam se, Mufera Šinik je na službenom putu, iz nevećinskih zajednica koji će spasiti ovu stvar i danas glasati za napredak Kosova. A neka drugi i dalje drže patriotske govore. Hvala!

KRYETARI: Zonja Gaxherri, urdhëro!

BESA GAXHERRI: Tash, pas kolegut pak me mbeti të them, por zoti kryetar, ne secili deputet këtu kemi përgjegjësi, sepse secili veç e veç e kemi marrë votën. Është e padrejtë, e papranueshme që dy ditë, që dy ditë ne që jemi këtu, po rrimë për këtë pikë të rendit të ditës, por ata deputetë të cilët nuk kanë përgjegjësi dhe mungojnë këtu.

Ju lutem, le ta dinë qytetarët e Kosovës, thërrisni me emra deputetët të cilët nuk kanë përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe votës së tyre dhe ndaj çështjeve të cilat i pret shteti ynë prej nesh. Kjo është e pakuptimtë, definitivisht e pakuptimtë. Ne jemi qe dy ditë duke pritur kot. Sidomos, ne që vijmë nga zona me nga 100 km. Nesër është fundi i vitit, ne të gjithë kemi familje, sidomos ne gratë, që po na presin atje. Duke u nisur prej jush atje, shkoni kryeni shumë punë, vini kur të ju dalë kohë për të ardhur në Kuvend... kjo është e papranueshme. Është kjo pikë shumë e ndjeshme, tash po them sinqerisht, është e ndjeshme, sepse unë tash do të çohesha në mënyrë demonstrative të shkoj. Kjo është lojë!

Edhe si ai deputet, i cili nuk vjen, ju e thërrisni në telefon, e lusni dhe i thoni faleminderit që erdhe me e bë kuorumin! Ne të cilët kemi përgjegjësi e ndjejmë atë, ne duhet t'i presim ata. Kjo është e papranueshme, kësaj duhet t'i vijë fundi, definitivisht fundi.

KRYETARI: Faleminderit! Kolegë deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Lus kolegët deputetë, që me ngritje dore të deklarohej! Kush është për? Kush është kundër? Atëherë, sa janë? Kush abstenon? 4 abstenime. 58 deputetë janë për, 4 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe komisionet e përhershme, që në pajtim me vendimin e seancës së sotme ta shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime para seancës plenare që do të mbahet po sot, më 30 dhjetor 2016. Tani do ta marrim kohën nga komisionet. Në orën sa?

Vetëm, në ndërkohë, para se ta përcaktojmë orën, zoti Zenun Pajaziti ka një njoftim për seancë, në të cilën merret vendimmarrja. Urdhëro!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Dëshiroj të bëj një propozim për një ndryshim në plotësim në komision, meqenëse do të kemi mungesë anëtarësh dhe kërkoj mbështetjen e seancës në këtë drejtim. Në vend të Flora Brovinës, që është kryesuese e Komisionit FunkSIONAL, për shkak të mungesës së saj unë propozoj zotin Nehat Baftiu, që të jetë pjesë e komisionit, në mënyrë që të funksionojë. Unë e kam prezantuar edhe me shkrim në sekretari, dëshiroj një mbështetje formale të... domethënë, nënkryetari i komisionit e drejton, besoj, komisionin sipas rregullores.

KRYETARI: Faleminderit! Duhet votim formal. Grupi parlamentar... 63 deputetë jemi në sallë. Ngritje formale e dorës. Kundër nuk ka. Aprovohet. Ka një abstenim. Kryetar i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të Flora Brovinës, emërohet deputeti Nehat Baftiu. Faleminderit! Seanca do të mbahet pas një ore, në 18:15.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*